



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Punonjës Social”**

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Anisa SUBASHI**

**Dr. Eris DHAMO**

**Korrik / 2023**



**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në “Punonjës Social”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Punonjës Social”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e MASH Nr. 4278 Prot, datë 01.07.2004
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 266, datë 10.08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021 34 studentë; Viti 2021-2022 44 studentë; Viti 2022-2023 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	





## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit (UE) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt.12.11.1991. UE i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 49, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2026. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij pesë fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Shkencave Humane
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
4. Fakulteti i i Ekonomisë
5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Punonjës Social” është hapur në vitin 2004 me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Nr. 4278 prot, datë 01.07.2004). Prej vitit 2007, programi i studimit ofrohej nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, i cili u krijua në vitin 2007 (Vendim nr. 821, Këshilli i Ministrave) gjatë një riorganizimi të Departamentit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Nga shkurti i 2012 Departamenti i Psikologji–Sociologjisë dhe Shkencave të Edukimit, u nda për t’u krijuar më pas dy departamente: ai i Shkencave Sociale ku ky program studimi bënte pjesë dhe Departamenti i Psikologjisë. Prej nëntorit të vitit 2021 (Vendim Nr. 28/1, dt. 09.11.2021) ky program ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar.

Programi i studimit të ciklit të parë është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi synon të përgatisë specialistë të punës sociale, me njohuritë bazë të domosdoshme dhe integruese për ciklet e tjera të studimit; t’u japë studentëve njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi specifike në një gamë të gjerë profesioneve e specialitetesh. Programi synon të përgatisë kuadro të aftë, të cilët mund të angazhohen apo punësohen sipas kërkesave të tregut të punës në: institucione arsimore; institucione të kujdesit social; OJF të cilat ofrojnë shërbime sociale; Institucione të shërbimit social, qendror dhe lokal etj.





## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 20.12.2021, Universiteti Aleksandër Xhuvani ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në "Punonjës Social". ASCAL bazuar në manualin "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm të cilët bazuar në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) si dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), të programit të studimit Bachelor në "Punonjës Social të Universitetit Aleksandër Xhuvani dhe në vizitat e kryera në këtë institucion, kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në "Punonjës Social. Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën 2 ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Dr. Eris Dharmo dhe Dr. Anisa Subashi. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj Majlinda Demireli. GVJ-se ju vu në dispozicion i gjithë dokumnatcioni i dorëzuar nga UNIEL (DVV) në datën 9.11.2022, pas shqyrtimit të këtij dokumnatcioni nga GVJ, u hartua dhe agjenda e vizites në institucion, të cilat u zhvilluan në datat 9 dhe 10 Janar 2023, në ambientet e institucionit. Gjatë vizitave ekspertëve ju vendos në dispozicion një sallë e dedikuar për të kryer takimet e planifikuara sipas agjendës. Ndërkohë që u kërkua dhe dokumentacion shtesë i cili ju vu në dispozicion GVJ. Bazuar në DVV, në intervistat me pyetje të përcaktuara të GVJ, sipas fokus grupeve të përcaktuara në agjendë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit Bachelor në "Punonjës Social. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Në përfundim të këtij Raporti, paraqitet në formë të përmbledhur një analizë përfundimtare mbi programin e studimit Bachelor në "Punonjës Social si dhe rekomandimet përkatëse për institucionin.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/61 Prot, datë 03.05.2023. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", përcjell në ASCAL më datë 16.05.2023, me anë të shkresës me Nr. 642/45 Prot, datë 15.05.2023, "Kthim përgjigje tuajën nr. 2/61, datë 03.05.20203 njoftim për dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm".

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentet si më poshtë:*



**1. Për Komentin që i përket standardit I.2, kriteri 1:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nevojën e përfshirjes në aktet rregullatorë të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rolin / detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**2. Për Komentin që i përket standardit II.4, kriteri 2:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me sugjerimin për respektimin e përcaktimeve e përqindjes totale të lëndëve sipas kategorive, referuar aktet rregullatore (VKMnr.41/2018). **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**3. Për Komentin që i përket standardit III.1, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nevojën e përfshirjes në lëndët e disiplinave të formimit të përgjithshëm, atij specifik, formues dhe karakterizues të programit të cilat janë veprimtari shkencore të fushës punonjës social, pedagogë të cilët janë kualifikuar në këtë fushë duke karakterizuar kështu diplomimin në “Bachelor në Punonjës Social”. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**4. Për Komentin që i përket standardit IV.1, kriteri 1:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit për fushën kërkimore ose ekspertizën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçoritë e moduleve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**5. Për Komentin që i përket standardit IV.1, kriteri 2:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me ngarkesën e lartë për një pjesë të stafit akademik efektiv dhe moszotërimin e dijeve në punë sociale, gjë e cila ndikon negativisht në përgatitjen e punonjësve socialë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**6. Për Komentin që i përket standardit IV.3, kriteri 1:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nevojën e vënies në dispozicion të studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse në **gjuhën shqipe**, e cila garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuar në programin e studimit “Bachelor në Punonjës Social”. Gjithashtu të ndërtohen plane konkrete mbi pasurimin dhe përditësimin e fondit fizik të librave në shqip, si dhe e gjithë literatura e detyruar e cila gjendet në programet e lëndëve të jetë pjesë e fondit të bibliotekës.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**7. Për Komentin që i përket standardit IV.3, kriteri 2:**


GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nevojën e përditësimeve të literaturës nga njësia përgjegjëse me botime të viteve të fundit për programin “Bachelor në Punonjës Social”. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**8. Për Komentin që i përket standardit IV.3, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me domosdoshmërinë e ekzistencës së teksteve mësimore bazë në gjuhën shqipe dhe literaturës ndihmëse të mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, si dhe libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të programit të studimit “Bachelor në Punonjës Social”. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**9. Për Komentin që i përket standardit IV.5, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst se vlerësimi i referohet mungesës së periodicitetit të auditimeve dhe të vlerësimeve mbi financimin dhe efektivitetin financiar si një mundësi për të gjykuar dhe bazuar vendimmarrjen edhe për programin i cili akreditohet. edhe në dokumentacionin shoqërues edhe në komentet tuaja juve i referoni vetëm 1 (një) dokumenti, i cili është *Evidenca I.11*, e cila është analizuar dhe është konsideruar për vlerësimin e përgjithshëm të standardit, por jo për periodicitetin e analizave të cilat duhet të realizohen çdo vit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Punonjes Social”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, është institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi në përputhje të plotë me vlerat më të larta dhe interesat kombëtare. Në Statutin (2018, i ndryshuar me vendim nr. 6, dt. 17.02.2022), Neni 2 i tij “Misioni” theksohet se: “UE si institucion i arsimit të lartë ka për mision të mbështesë prioritetet strategjike të vendit”.</p> <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHE-së” theksohet se: “FSHE ka për mision: Të krijojë, të nxisë dhe të zhvillojë programe studimi bashkëkohore në sinkron me nevojat e tregut të punës në vend; të fuqizojë programet e studimit me vlera historike kombëtare në shërbim të rritjes së të menduarit kritik duke përgatitur specialistë, të cilët do të mund të kontribuojnë në ngritjen e nivelit të demokracisë në vend dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës drejt integritetit të vendit në BE; të nxisë mundësinë e kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për profesorët dhe studiuesit e rinj; të jëtë promotor i politikave arsimore në arsimin parauniversitar nëpërmjet instrumentave shkencore; të jetë kontribues në zhvillimin e politikave kombëtare e lokale në përputhje me parimet kushtetuese dhe strategjitë europiane të zhvillimit të shoqërisë në tërësi”.</p> <p>Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Punonjës Social” ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar (DSHSEQ), në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (FSHE) të UE-së, është në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor në Punonjës Social” i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. (Evidenca 1.1 Statuti i UE dhe Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHE-së)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe	Programi i studimit Bachelor në Punonjës Social është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin si dhe fushën e





<p>ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>veprimtarisë së UE-së, FSHE-së, DSHSEQ. Ky kriter shprehet më së miri në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statutin e UE (2018, i ndryshuar me vendim nr. 6, dt. 17.02.2022), <i>Neni 2</i> “Misioni”, ku IAL deklaroi se “UE ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me interesat e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë; të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës”.</li> <li>- Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2024 theksohet: “Objektivi kryesor i UE-së është të formojë profesionistë të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave humane, natyrore, ekonomike, të edukimit si dhe shkencave mjekësore e teknike”</li> </ul> <p><i>(Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL, fq. 7-Objektivat- Statutin e UE)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Punonjës Social është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p> <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHE-së 2020-2024” theksohet se: “FSHE synon të mbetet fakulteti i një rëndësie të veçantë në vend. Duke kthyer traditën në sukses, të jetë fakultet lider në vend përsa i përket programe kyçe dhe të një rëndësie të veçantë siç janë programet e mësuesisë, punës sociale, psikologjisë, edukimit fizik dhe sporteve, programeve Master në AMU, programeve Master Profesional dhe Shkencor dhe jo vetëm”. <i>(fq. 4, Vizioni i FSHE)</i></p> <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të Departamentit të Shkencave sociale 2021-2025” citohet se: “Misioni i Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar është përgatitja e studentëve si profesionistë të kualifikuar me aftësitë e nevojshme për t’u përfshirë në aktivitete që i shërbejnë zhvillimit shkencor, zgjidhjes së problemeve sociale dhe përmirësimit të jetës së komunitetit si dhe nxitja procesit të punësimit të tyre në sektorin publik dhe privat të ofrimit të shërbimeve sociale”, dokument i pare gjatë vizites.</p> <p>-Në dokumentin “Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Punonjës Social” <i>Neni 2</i>, ku theksohet se: “Kjo rregullore është në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe</p>



	<p>Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit, Rregullores së studimeve për Universitetin dhe Fakultetin.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UE-së;</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit, ku ofrohet programi i studimit është pjesë përbërëse e strukturës akademike të UE-së i cili përbëhet nga katër njësi bazë dhe një qendër kërkimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Edukim Fizik dhe Sporte;</li> <li>2. Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies;</li> <li>3. Departamenti i Psikologjisë;</li> <li>4. <b>Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar;</b></li> <li>5. Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim;</li> </ol> <p>Referuar (2.7 Aneks Tabelë Përmbledhese tabela nr.1) rezultoni se Fakulteti i Shkencave të Edukimit për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>91 pedagogë</b>, nga të cilët <b>39 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 3 kanë titullin “Profesor”, 15 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 19 kanë gradën Dr./PhD, dhe 2 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>52 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 5 kanë titullin “Profesor”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 14 kanë gradën Dr./PhD. dhe 26 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departament për vitin akademik 2021-2022, janë <b>9 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE)</b>, nga të cilët 2 janë me titullin “Profesor i Asociuar”, 6 me gradën Dr dhe 1 Asistent Lektorë me Msc. Në departament janë të angazhuar dhe <b>3 personel akademik me kontratë (PAK)</b>, nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 1 ka gradën Dr./PhD dhe 1 me “Master i Shkencave”.</p> <p>Pë sa më sipër FSHE dhe DSHSEQ demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin</p>	<p>Në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHE-së 2020-2024” theksohet se vizioni i saj është që: “FSHE synon të mbetet fakulteti i një rëndësie të veçantë në vend. Duke kthyer traditën në sukses, të jetë fakultet lider në vend përsa i përket programeve kyçe dhe të një rëndësie të veçantë siç janë programet e mësuesisë, punës sociale, psikologjisë, edukimit fizik dhe sporteve”.</p>






<p>e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Referuar dokumentit “Evidenca 2.7-Aneks Tabela përmbledhëse”, DSHSEQ ofron 6 programe studimi, nga të cilat 3 programe studimi Bachelor (në të cilat përfshihet edhe programi Bachelor në Punonjës social), 2 programe studimi master profesional dhe 1 program studimi Master i Shkencave.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DSHSEQ, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit BaPS</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nga vlerësimi i evidencave dhe vizita ne institucion shprehet se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ofron programe studimi në përputhje të plotë me vlerat më të larta dhe interesat kombëtare. Ai demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Punonjes Social është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së</p>	<p>FSHE, në UE, demonstroi angazhimin e vet, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Statutin e UE-së dokumentet rregullatore, aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunim brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Në Rregulloren e Organizimit të</p>






<p>detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Studimeve në FSHE theksohet se ajo: “Ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave, detyrave, përgjegjësive lidhur me realizimin e studimeve në Fakultetin të Shkencave të Edukimit. Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj mbi personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, si dhe studentët e FSHE-së. Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse të FSHE-së”.</p> <p>Në <i>Nenin 3</i> përcaktohet se: “Çdo program studimi në FSHE ka rregulloren e tij. Rregullorja e programit të studimit hartohet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit dhe miratohet në Senatin Akademik, së bashku me programin përkatës të studimit”.</p> <p>Në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Punonjës social theksohet se: “Kjo rregullore shërben për mbarëvajtjen e punës për realizimin e Programit të studimit Bachelor në Punonjës Social në Fakultetin e Shkencave të Edukimit”.</p> <p>Edhe pse në Rregulloren e FSHE-së apo në atë të programit të studimit mungon përshkrimi i rolit dhe detyrave të koordinatorit të programit të studimit, në aktet rregullatore (<i>Evidenca 2.4-Përcaktimi i koordinatorëve në programin e studimit Bachelor në Punonjës social</i>), janë përcaktuar koordinatorët e programit të studimit Bachelor në Punonjës social. Po ashtu, në dokumentin (<i>Analiza vjetore e punës mësimore të DSHS Evidenca 1.14</i>) theksohet se: “koordinatorët e programeve të studimit kanë koordinuar punën midis problematikave që kanë shfaqur studentët”.</p> <p><i>GVJ, rekomandon të përfshihet në aktet rregullatore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë roli, detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL;</i>  <i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i>  <i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me një numër të lartë institucionesh homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Janë rreth 60 institucione të tilla vendase dhe të huaja. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, janë të pasqyruara në analizën vjetore institucionale.</p>





<p>vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p><i>Evidenca 1.12-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>FSHE si pjesë përbërëse e UE-së, dëshmon përmes dokumentit “Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave” (<i>Evidenca 1.13</i>) se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve brenda vendit publike apo private për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve, të cilët ndjekin programin e studimit Bachelor në Punonjës Social. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale të UE/FSHE/DSHSEQ:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;</li> <li>2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan;</li> <li>3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Elbasan;</li> <li>4. Spitali Psikiatrik "Dr.Sadik Dinçi", Elbasan;</li> <li>5. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;</li> <li>6. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;</li> <li>7. Halimi Foundation Institute;</li> <li>8. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës;</li> <li>9. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare;</li> <li>10. Kuvendi i Shqipërisë;</li> <li>11. Elite Travel;</li> <li>12. Spitali Rajonal Elbasan;</li> <li>13. Bashkia Elbasan;</li> <li>14. Drejtoria Rajonale e Shëndetit Elbasan;</li> </ol> <p>Ndërkohë që lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UE-së me universitete, institucione, agjenci vendase apo të huaja përfshin rreth 60 të tilla. (<i>Evidenca 1.12</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DSHSEQ, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Punonjës Social.</p> <p>Në dokumentin “Analiza vjetore e punës mësimore të DSHS” (29.09.2021) dhe “Analiza vjetore e punës mësimore të DSHSEQ” (30.09.2022) merret në analizë realizimi i praktikës mësimore në institucione të ndryshme (<i>Evidenca 1.14, fq. 11 dhe fq. 14</i>).</p>





	Referuar dokumentit “Analiza vjetore e punës mësimore kërkimore 2021-2022 të FSHE”, datë 6.10.2022 (Evidenca 1.11) theksohet se: “Praktikat profesionale ose institucionale janë realizuar me problematika të vogla, të cilat kanë marrë zgjidhje të menjëhershme. Janë arritur në kohë të realizohen Marrëveshjet e Praktikave me Istitucionet duke mos penguar shpërndarjen në rrethe të studentëve si dhe është ndjekur një standard në mënyrën e shpërndarjes duke ruajtur dokumentacionin për çdo program studimi” (fq. 6). (Evidenca 1.14 Analiza vjetore e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar)			
<b>Konkluzione</b>	GVJ nga vlerësimi i evidencave dhe vizita ne ambientet shprehet se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me	Përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për IAL janë pasqyruar në Statutin e UE-së ku në <i>nenin 47</i> “Ciklet dhe programet e studimeve” deklarohet se: “Programet e studimeve organizohen ne module dhe vlerësohen ne kredite, në përputhje me Sistemin Europian te Transferimit te Krediteve (ECTS)”.  Në Rregulloren e studimeve në UE (miratuar nga SA me vendim nr. 3, datë 28.01.2020), <i>neni 10</i> , theksohet: “UE ofron programe



legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS)”.

Në Rregulloren e organizimit të studimeve në FSHE, *Neni 7, “Ciklet dhe programet e studimit në FSHE” (Evidenca 1.7)* thuhet se: “FSHE ofron programe të studimeve të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programet e studimeve në FSHE organizohen në dy cikle: cikli i parë dhe cikli i dytë referuar niveleve 6-7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve”. Në pikën 2 të këtij neni deklarohet: “Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite”.

Më tej në *nenin 19 “Kreditet e formimit universitar”* thuhet: “Kreditet e formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.


Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe”.

Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social përcaktohet se: “Programi zgjat tre vite akademike. Ai përmban 180 kredite, 60 në secilin vit.”

Bazuar në dokumentet e sipërcituara, program i studimit Bachelor në Punonjës Social është i organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës shqiptare të Kualifikimeve. (*Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10, Plani mësimor; Evidenca 2.10 “Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social)*




<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor Punonjës Social synon të përgatisë specialistë të punës sociale, me njohuritë bazë të domosdoshme dhe integruese për ciklet e tjera të studimit; t'u japë studentëve njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi specifike në një gamë të gjerë profesionale e specialitetesh. Ky synim gjen shprehje në dokumentin “Model diplome-Suplementi i diplomës” (Evidenca 3.16).</p> <p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social jep njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Në dokumentin “Model diplome-Suplementi i diplomës” theksohet se:</p> <p>“Ky program studimi synon: -të përgatisë specialistë të punës sociale, me njohuritë bazë të domosdoshme dhe integruese për ciklet e tjera të studimit; t'u japë studentëve njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi specifike në një gamë të gjerë profesionale e specialitetesh; -të përgatisë kuadro të aftë, të cilët mund të angazhohen apo punësohen sipas kërkesave të tregut të punës”.</p> <p>Në dokumentin Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit 2020-2024” (Evidenca 2.9) theksohet se: “Objektivi kryesor i FSHE-së është të formojë profesionistë të rinj, konkures në tregun e punës në fushat e mësuesisë, shërbimeve sociale psikologjike”.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Plani Mësimor Tabela 10;</i>  <i>Evidenca 2.7, Aneks Tabela 14 Syllabuset e lëndëve;</i>  <i>Evidenca 2.10 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i>  <i>Evidenca 2.11 Propozim për ndryshime në planet mësimore;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar dokumentit “Aneks-Tabela përmbledhëse Evidenca 2.7. tabela 9) ” rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180 kredite. Përqindja për secilin tip të komponentit mësimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. lëndët bazë - 30 Kredite/ 16.7%</li> <li>B. lëndët karakterizuese - 91 Kredite/ 50.5%</li> <li>C. lëndët ndërdisiplinore - 24 Kredite/ 13.3%</li> <li>D. lëndët plotesuese - 30 Kredite/ 16.7%</li> <li>E. detyrimet përmbyllëse - 5 Kredite/ 2.8 %</li> </ul>





<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Referuar Planit Mësimor Bachelor Punonjës Social (<i>Evidenca 2.10</i>), praktika në institucione zhvillohet në formën e praktikës dhe praktikumeve gjatë vitit të parë dhe të dytë dhe praktikë e pandërprerë (bllok) në institucione për 4 javë në semestrin V dhe VI (viti i tretë) me 18 kredite në total (10% të krediteve të përgjithshme), 6 për secilin vit akademik, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit, ndërsa detyrimet përmbyllëse zenë 2.8% të krediteve në total (5 ECTS).</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 Plani mësimor;</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i></p> <p><i>Evidenca 2.11 Propozim për ndryshime në planet mësimore;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në dokumentin Statuti i UNIEL, kreu VII, neni 46, “Format e studimeve dhe pranimi i studentëve” pika 1, thuhet se: “<i>Forma e studimeve në UE është: Studime me kohë të plotë</i>”. Më tej në pikën 4 shprehet: “<i>Pranimi dhe regjistrimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjor në fuqi</i>” (fq. 30).</p> <p>Referuar dokumentit “Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet” (<i>Evidenca 2.1</i>) konstatohet se modelet e financimit të studentëve janë: Financimi nëpërmjet bursave dhe financimi nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosur me aktet nëligjore. Në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UNIEL.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, Pika 2.4/a “<i>Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit</i>”, përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;</li> <li>ii. studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;</li> <li>iii. përgatitje për provime;</li> </ul>





iv. përgatitje e tezës së diplomës;

v. veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private;

Referuar dokumentit “Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social” (Evidencë 2.10), janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018, për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të parë, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018	Sipas planit mësimor
<b>A</b>	Lëndë Bazë	15%-20%	16.7%
<b>B</b>	Lëndë karakterizuese	50%-55%	50.5%
<b>C</b>	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	12%-15%	13.3%
<b>D</b>	Lëndë plotësuese	10%-15%	16.7%
<b>E</b>	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	2.8%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social të paraqitur në dokumentin “Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës” me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të parë, nxjerr në pah se të dhënat janë thuajse në përputhje.

- Në kategorinë D ka një diferencë prej 1.7% kredite më tepër, ndërsa në Kategorinë E (Detyrime përmbyllëse) ka 0.2% kredite më pak;
- Përqindja totale e lëndëve të kategorisë A dhe B është më pak se 70 %; në mospërputhje me Shtojca (Tabela 1)

Rezultatet e vlerësimit për kriterin 6, tregojnë se programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social, ka të specifikuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, ku vërehet se kategoritë e



	programit thuajse përputhen me përcaktimet lidhur me ngarkesën respektive në kredite		
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit që formohet prej shkronjave nistore të emërimit të programit dhe emërimit të secilës lëndë ( <i>Evidenca 1.9</i> ).		
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në Punonjës Social, është organizuar sipas ligjit 80/2015 dhe ofrohet vetëm nga DSHSEQ/FSHE. <i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 Plani mësimor;</i> <i>Evidenca 2.10 "Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ nga vlerësimi i evidencave dhe vizita në ambientet shprehet se Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ofron programe të studimeve të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në	UE është akredituar me Vendimin Nr 49 të vitit 2020 të Bordit të Akreditimit për 6 vite. FSHE, që ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Në Statutin e UE-së Kreu II, "Organizimi akademik dhe




<p>legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>administrativ i Universitetit të Elbasanit”, <i>Neni 5</i>, Struktura e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, theksohet se <i>UE përbëhet nga 5 njësi kryesore</i>, njëra prej të cilave është FSHE.</p> <p>Sipas Statutit (ndryshuar me vendim nr. 6, dt. 17.02.2022), <i>Neni 7</i> (Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6, datë 17.02.2022), “Organigrama e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, njësia bazë e emërtuar “Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar” është në përbërje të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, i cili përbëhet nga 5 njësi bazë (fq. 6). Këto njësi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar;</li> <li>2. Departamenti i Psikologjisë;</li> <li>3. Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies;</li> <li>4. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit;</li> <li>5. Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim;</li> </ol> <p><i>Në tabelën 1 të Evidences 2.7</i>, paraqitet numri i personelit për çdo njësi bazë të FSHE, evidentohet që të 5 njësitë kanë në përbërje 7 PAE duke plotësuar kriterin ligjor në lidhje me numrin.</p> <p><i>Në tabelën 2 të Evidences 2.7</i> evidentohet që DSHSEQ ka <b>9 PAE</b> (duke plotësuar kriteret ligjore) nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof.Asoc;</li> <li>- 6 Dr;</li> <li>- 1 Msc;</li> </ul> <p><b>3 PAK</b>, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof.Asoc;</li> <li>- 1 Dr;</li> <li>- 1 Msc;</li> </ul> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHE) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin (DSHSEQ), përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik;</li> <li>- organizimin dhe strukturën akademike;</li> </ul> <p><i>(Evidenca 2.7 Aneks-Tabela përmbledhëse, Tabela 1 dhe Tabela 2).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e studimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit” (<i>Evidenca 1.7</i>), neni 32 “Organizimi i praktikave profesionale/mësimore/spitalore” thuhet se: “Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës, kur ajo</p>





<p>përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>përfshihet në planet mësimore. Me fillimin e vitit akademik, dekanati u komunikon studentëve nëpërmjet departamenteve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Praktikrat zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e personit përgjegjës të caktuar nga departamenti. Mënyra e zhvillimit dhe e vlerësimit të praktikës përcaktohet nga Departamenti, i cili harton dhe miraton paketën me modelet/formatet standarde përkatëse të dokumentacionit të praktikës dhe ua shpërndan studentëve. Përgjegjës për mbledhjen dhe vlerësimin e dokumentacionit të praktikës është pedagogu, i cili është ngarkuar me praktikrat në fillim të vitit akademik”.</p> <p>Gjate vizites dhe takimeve me stafin, ata dëshmuar se departamenti vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për praktikën profesionale. Në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, shpërndan ngarkesën mësimore të praktikës te stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, i cili mbulon programin e studimit, si dhe cakton një supervizor të praktikës për studentët. Supervizori i praktikës është staf akademik me kohë të plotë pranë DSHSEQ. Ai mbështet formalizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Elbasanit “Alekdandër Xhuvani” (FSHE/DSHSEQ) dhe Institucionit ku studentët do të realizojnë praktikën profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional për zhvillimin e praktikës nga studentët, janë vjetore me të drejtë të përsëritjes së saj çdo vit (<i>Evidenca 1.13 Lista marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i>).</p> <p>DSHSEQ, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar një manual të detajuar për zhvillimin e praktikës në institucione, ku janë përcaktuar modalitete të vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervizorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve etj. (<i>Evidenca 4.17.1-Modeli dokumentet e praktikës</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është</p>	<p>Referuar dokumentit “Përcaktimi i koordinatorëve në programin e studimit BaPS” (<i>Evidenca 2.4</i>), DSHSEQ, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit për çdo vit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Përcaktimi i tyre bëhet nga drejtuesi i departamentit në fillim të</p>






<p>përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>çdo viti akademik. Në dokumentin Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social (<i>Evidenca 1.8</i>) thuhet se: “Departamenti ngarkon një pedagog për çdo 6 studentë si kujdestar ose tutor të tyre. Tutori që zgjidhet nga pedagogët që japin mësim direkt me kandidatët i orientojnë ata së pari për qëllimet e kurrikulës dhe ndihmon në vështirësitë e fillimit si p.sh i orienton në zgjedhjen e lëndëve opsionale dhe për organizimin e punës së pavarur. Tutori orienton studentët në zgjedhjen e fushës shkencore të temës sipas synimeve dhe aftësive të tyre dhe i prezanton atyre profesoratin që udhëheq temën e diplomës. Tutori jep orientime dhe ndërmjetëson kur është e mundur për tregun e punës”. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, edhe studentët e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, konfirmuan ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me koordinatorin e programit të studimit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Gjatë vizitës në institucion, koordinorët e Programit “Bachelor në Punonjës Social”, shpjeguan se “Caktimi i Koordinatorit të Programit ka për qëllim të lehtësojë punën e DSHSEQ dhe të sigurojë mbarëvajtjen e programit të studimit, ecurinë e mësimdhënies në program, si dhe të raportojë te Përgjegjësi i Departamentit mbi problematikat e ndeshura në procesin mësimor, për të marrë masa e nevojshme dhe siguruar zgjidhje një kohë sa të shpejtë”. Kriteri përmbushet plotësisht</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p>X</p>

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p>	<p>Në Rregulloren e studimeve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, <i>Kreu IV</i> “Organizimi i studimeve”, në tërësinë e neneve të saj, përcaktohet baza rregullatore për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga FSHE.</p> <p>Nëpërmjet dokumentit Aneks-Tabela përmbledhëse (<i>Evidenca 2.7</i>) jepen informacionet e nevojshme për organizimin,</p>






<p>dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim.</p> <p>Gjithashtu, Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës social përmban informacionet e nevojshme për strukturën dhe përmbajtjen e programin e studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim.</p> <p>Në <i>kreun VII</i> të dokumentit “Rregullore e studimeve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit (2020)”, përshkruhen qartë procedurat e diplomimit të studentëve të programeve të studimit Bachelor, Master profesional, Master i Shkencave dhe përcaktohen përgjegjësitë e strukturave akademike, ndihmësakadematike dhe administrative të përfshira në procesin e diplomimit (<i>Evidenca 1.7</i>). Në të përcaktohet: “Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Për t’u diplomuar me provim diplome, studenti në përfundim të dy viteve të para, duhet të ketë siguruar një notë mesatare jo më të vogël se 8 (tetë)” (fq. 8).</p> <p>Edhe në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social”, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, ka përcaktuar procedurat e diplomimit të studentëve në programeve të studimit Bachelor.</p> <p>Bazuar në dokumentet e mësipërme, FSHE/DSHSEQ përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim, dëshmojnë se disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 Plani mësimor BaPS;</i>  <i>Evidenca 2.10 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Punonjës Social përmban Planin mësimor (<i>Evidenca 2.10</i>), ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore dhe komponentë të tjerë.</p> <p>Në dokumentin “Rregulloren e studimeve të FSHE”, <i>nenet 37 dhe 38</i> përcaktohen qartë kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit si dhe format e kontrollit të dijeve.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social” (<i>Evidenca 1.8</i>), mes të tjerash, përfshihet informacion për mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve.</p>





	<p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pika 2.1/dh “Kreditet sipas ECTS-së”, mes të tjerash specifikohet se “Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm)”. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor vërehet se është pasqyruar edhe informacioni për formën e kontrollit të dijeve/shlyerjes së lëndëve/moduleve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 , Plani mësimor BaPS;</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social Evidenca;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL për programin e ciklit të parë, Bachelor në “Punonjës Social”, u siguron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalencën e studimeve. Rregullat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit janë të parashikuara në Rregulloren e Fakultetit.</p> <p>Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë. Këto përcaktime gjejnë pasqyrim në Rregulloren e studimeve të FSHE (2020), Kreu IV “Organizimi i studimeve”, si dhe Kreu VI “Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit” përmes neneve: <i>neni 48</i> “Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit”, <i>Neni 50</i> “Transferimi i studimeve”, <i>Neni 51</i> “Procedura për transferimin e studimeve”, <i>Neni 52</i> “Ndërrimi i programit të studimit”, <i>Neni 53</i> “Ndjekja e një program të dytë studimi”, ku janë përshkruar të gjitha modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit që lidhen me procedurën e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Për sa më sipër, programi i studimit Bachelor në Punonjës Social përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me përmbushjen e kriterit 3.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti UE, Neni 48, neni 49, neni 57, neni 58; Evidenca Rregullore e studimeve Neni 13, neni 14;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Punonjës Social përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e</p>





<p>informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Referuar Programeve mësimore të lëndëve të programit Bachelor në Punonjës Social, vërehet se të gjitha syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/specifikë të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminarëve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar, etj.</p> <p>Modeli i Programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor në Punonjës Social (<i>Evidenca 2.7-Aneks Tabela përmbledhëse, Tabela 14</i>) përmban të gjitha elementet në përputhje me formatin e miratuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Punonjës Social (<i>Evidenca 1.8, Neni 4</i>) thuhet se: “Programi zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe ka si strukturë përgjegjëse këtë Fakultet”.</p> <p>FSHE i përmbahet kuadrit rregullator dhe udhëzimeve të UE për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Në dokumentin Rregullorë e studimeve UNIEL (<i>Evidenca 1.2, Neni 20</i>) “Hapja dhe riorganizimi i programeve të studimit”, pika 6 thuhet: “UE për programe studimi të akredituara mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20% dhe t’i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati akademik dhe për to njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.</p> <p>Në dokumentin “Propozim për ndryshime në planet mësimore” (<i>Evidenca 2.5</i>) përshkruhen ndryshimet e propozuar në Planin mësimor të Programit të studimit Bachelor në Punonjës Social si dhe programe të tjera të këtij fakulteti.</p> <p>Në funksion të arritjes së objektivave, DSHSEQ: - Rishikon çdo fillim viti syllabuset duke reflektuar mbi të gjitha elementet për përmirësimin e programit të studimit; - Monitoton të gjitha proceset e veprimtarive akademike (leksione, seminare dhe praktikë mësimore) duke filluar që nga momenti i regjistrimit</p>






	<p>të studentit deri në diplomimin e tij, duke përfshirë monitorimin e zhvillimit të të gjithë procesit mësimor dhe cilësinë e procesit të vlerësimit; - Reflekton mbi të dhënat e mbledhura nga evidencat (pyetësorë me studentë) për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të zhvillimit profesional në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>FSHE/DSHSEQ janë të vetëdijshëm për nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të programit të marrë në vlerësim. Sipas RVB (2022), raportohet se: “Ndryshimet më të mëdha kurrikula i ka pësuar në vitin 2016 me hyrjen në fuqi të ligjit për arsimin, Nr. 80/2015, bazuar në nenin 72 dhe 75 për organizimin e programeve të studimit (Ligji Nr. 80/2015). Disiplinat e formimit të përgjithshëm u hoqën nga plani mësimor për t’i lënë hapësirë disiplinave që orientojnë studentin drejt specialitetit të masterit” (fq. 11).</p> <p><i>Evidenca 2.5 Propozim për ndryshim plani mësimor BaPS 2016;</i>  <i>Evidenca 2.6 shkresë informuese projekti Task datë 06.01.2021 me nr. prot.5;</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Dokumentet e mësipërme dhe diskutimi gjatë vizitës në institucion, mbi praktikat konkrete që ndërmerr institucioni për përmirësimin e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, dëshmojnë se përmbajtja e këtij programi është në proces përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit është e organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në pikën 2.4/b të VKM/2018 përcaktohet se “Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione,






<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë”.</p> <p>Shqyrtimi i Planit Mësimor, lidhur me ngarkesën vjetore/javore të një studenti me orë mësimore brenda/jashtë auditorit për çdo vit akademik, tregoi si më poshtë:</p> <p>- <b>Viti I</b> përmban 60 kredite = 1500 orë në vit, nga të cilat 720 orë në auditor dhe 780 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 24 orë mësimore në javë brenda auditorit dhe 26 orë në javë jashtë auditorit;</p> <p>- <b>Viti II</b>, përmban 60 kredite = 1500 orë, nga të cilat 735 orë në auditor dhe 765 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 24.5 orë në javë brenda auditorit dhe 25.5 orë në javë jashtë auditorit;</p> <p>- <b>Viti III</b>, përmban 60 kredite = 1500 orë, nga të cilat 601 orë në auditor dhe 899 orë jashtë auditorit. Kjo ngarkesë mësimore realizohet në dy semestra me nga 15 javë/semestri ose 30 javë /viti akademik. Sipas kësaj strukture, një student zhvillon mesatarisht 20.5 orë në javë brenda auditorit, duke përfshirë edhe praktikën profesionale në të dy semestrat, dhe 30 orë në javë jashtë auditorit.</p> <p>Krahasimi i të dhënave për ngarkesën mësimore javore, për çdo vit akademik të pasqyruar në Planin Mësimor, tregon se në vitin e tretë të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social gjendet një numër relativisht më i madh i orëve jashtë auditorit (30 orë /javë) krahasuar me orët brenda në auditor (20.5 orë/javë).</p> <p>Në total ngarkesa mësimore brenda/jashtë auditorit, sipas Planit Mësimor 2021-2024 të programit Bachelor në Punonjës Social nga verifikimi, rezultoi se janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Orë në auditor</b> gjithsej 2056; Orë leksione 1151, Orë seminare 635, Orë praktike/laborator 270;</li> <li>- <b>Orë jashtë auditorit</b> 2444;</li> <li>- <b>Total</b> 4500 orë.</li> </ul> <p>Raporti në total midis orëve në auditor dhe jashtë auditorit është në favor të orëve jashtë auditorit me një diferencë 388</p>
--	---





	<p>orë (15.5 kredite) më shumë punë e pavarur/individuale e studentit.</p> <p>Në tërësinë e tij Plani Mësimor respekton përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, pikën 2.1/d ku shprehimisht thuhet se “Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe”. Përgjithësisht, Plani Mësimor 2021-2024, reflekton Rregulloren e FSHE (2018), Kreu III “Elementet e programeve të studimit”, Neni 19 “Kreditet e formimit universitar” ku specifikohet se “Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe”. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca 1.9 “Pasqyrimi i kodifikimit të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i></p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10, Plani mësimor;</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 “Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social Evidenca;</i></p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në dokumentin Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social (<i>Evidenca 2.10</i>) konstatohet se përmbajtja e tij sipas kategorive përkatëse dhe krediteve respektive është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="582 1601 1375 1948"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Përshkrimi</th> <th>Sipas VKM 41/2018</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>A</b></td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>15%-20%</td> </tr> <tr> <td><b>B</b></td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50%-55%</td> </tr> <tr> <td><b>C</b></td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/integru ese</td> <td>12%-15%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018	<b>A</b>	Lëndë Bazë	15%-20%	<b>B</b>	Lëndë karakterizuese	50%-55%	<b>C</b>	Lëndë ndërdisiplinore/integru ese	12%-15%
Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018											
<b>A</b>	Lëndë Bazë	15%-20%											
<b>B</b>	Lëndë karakterizuese	50%-55%											
<b>C</b>	Lëndë ndërdisiplinore/integru ese	12%-15%											





<b>D</b>	Lëndë plotësuese	10%-15%	16.
<b>E</b>	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	2.8

Kategoria A-E	Viti I		Viti II		Viti III	
	Lëndë	Kredite	Lëndë	Kredite	Lëndë	Kredite
<b>A</b>	2	12	1	10	2	8
<b>B</b>	3	20	6	35	5	36
<b>C</b>	1	10	2	9	1	5
<b>D</b>	4	18	1	6	1	6
<b>E</b>	-	-	-	-	1	5
<b>Totali Lëndë/kredite</b>	10	60	10	60	10	60

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se lëndët bazë të programit të studimit (A), që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme, zhvillohen në të tre vitet, me një ngarkesë prej 16.7 % të krediteve, që është në përputhje me përcaktimin në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori (15% - 20% kredite).


Lëndët karakterizuese (B), që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij janë shpërndarë në tre vite akademike (3/6/5 lëndë), me rritje të numrit të lëndëve/ krediteve nga viti i parë në të dytin, dhe një ulje të lehtë të numrit të lëndëve/krediteve në vitin e tretë. Pësha specifike në kredite e lëndëve të kategorisë B rezultojnë 50.5 % kredite.

Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B rezultojnë më pak kredite (67.2% kredite), krahasuar me përcaktimet e VKM nr.41/2018, "Shtojca", ku shënohet se "Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor".

Lëndët ndërdisiplinore (C) dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje janë shtrirë gjatë tre viteve akademike barabartë lëndësh (1/2/1 lëndë) dhe rënie të krediteve në vitin e tretë.



	<p>Lëndët plotësuese (D), të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim, zënë 16.7% të krediteve, në raport me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori.</p> <p>Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social të paraqitur në dokumentin “Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës” me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të parë, nxjerr në pah se të dhënat janë thuajse në përputhje.</p> <p>Referuar VKM nr.41/2018, “Shtojca”, shënohet se “Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor”.</p> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të konsiderojë rritjen në intervalin 50% - 55% kredite të lëndëve të kategorisë B, sipas përcaktimeve të VKM nr.41/2018 për të respektuar përcaktimin për përqindjen totale të lëndëve të kategorive A dhe B (70%).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim janë pasqyruar lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse. Çdo lëndë në Planin Mësimor e parashikuar për t`u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimorë si: leksione, seminare dhe praktikë/laborator. <i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10, Plani mësimor</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në Planin Mësimor të programit të studimit janë pasqyruar 30 lëndë/disiplina (janë 38 lëndë/module në total), të ndara sipas kategorive A-E të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra dhe me kreditet përkatëse.</p> <p>Praktika në institucione zhvillohet e shtrirë në të tre vitet e studimit në formën e praktikës dhe praktikumeve, gjatë vitit të parë dhe të dytë dhe praktikë e pandërprerë (bllok) në institucione për 4 javë në semestrin V dhe VI (viti i tretë) me 18 kredite në total (10% të krediteve të përgjithshme), 6 për</p>





	<p>secilin vit akademik. Në takimin me stafin akademik dhe studentët e programit Bachelor në Punonjës Social, u shpjegua se “pothuajse në çdo lëndë/disiplinë të përgjithshme dhe ato karakterizuese realizohen punime, detyra kursi dhe raporte kërkimore nga studentët të cilat zënë nga 10% në 30% të vlerësimit përfundimtar”. Instruksionet në lidhje me strukturën, modalitetet dhe hapat e punimit studenti i merr nga pedagogu i lëndës, i cili kontrollon me shkrim dhe me gojë aktivizimin dhe cilësinë e punimit të studentit.</p> <p>Raporti teori-praktikë në programin e ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social (180 kredite) rezulton me 90% kredite teori dhe 10 % kredite praktikë profesionale. Praktika Profesionale përmban gjithsej 18 kredite (450 orë). Ky raport mundëson arritjen e objektivave formues të programit, si dhe lejon transferimin, mobilitetin dhe vijshmërinë e studimeve në programet e ciklit të dytë në degë të ndryshme të specialitetit.</p> <p>Në dokumentin “Rregullore e studimeve UNIEL” (Evidenca 1.2) përcaktohen modalitetet mbi praktikën e transferimit të studentëve në përputhje me përcaktimet në Nenin 51 “<i>Transferimi i studimeve</i>”, Neni 52 “<i>Procedurat e transferimit të studimeve</i>” dhe Neni 54 “<i>Ndërrimi i programit të studimeve</i>”.</p> <p>Gjithashtu, FSHE/DSHSEQ dëshmojnë për praktika të mira të përfshirjes së studentëve në projekte mobiliteti, duke filluar nga viti 2016 deri në vitin 2022.</p> <p><i>Evidenca 3.2 “Të dhëna për mobilitetin e stafëve”</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Për arritjen e objektivave formues dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, FSHE/DSHSEQ, si pjesë përbërëse e UE, dëshmojnë përmes dokumenteve “Lista marrëveshjeve të bashkëpunimit” (Evidenca 1.12) dhe “Lista marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave” (Evidenca 1.13) se kanë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjenci e biznese private, etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset) për tre vitet e studimit, rezulton se ato janë hartuar në përputhje me elementet e modelit sipas përcaktimeve në Shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, Pika 2.8 “Programi lëndor (syllabus-et)”, (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa</p>





	<p>ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca 3 “Programi i lëndës”).</p> <p>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literature ndihmëse. Në dokumentin “Rregulloren e organizimit të studimeve në FSHE” përcaktohet se: “Literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet dhe ciklet e leksioneve. Literatura bazë e detyrueshme miratohet nga departamenti, me propozimin e titullarit/pedagogut të lëndës. Një kopje e saj administrohet në departament. Literatura bazë e detyrueshme i bëhet e njohur studentëve në fillim të vitit akademik” (fq. 17).</p> <p>Lidhur me përditësimin e përmbajtjes së syllabuseve janë evidentuar disa praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden disa syllabuse që kanë përfshirë rishikimin e ciklit të leksioneve ose botime të 5 viteve të fundit. Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të rrisin përpjekjet dhe të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar me botime të 5 viteve të fundit. Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura bazë e detyruar dhe ndihmëse/e rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze. (Materiali “Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit). Gjatë takimit në institucion, stafi akademik shpjegoi se titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe. Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze. <i>Evidenca 2.9 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga diskutimet e vizites ne institucion vihet re se lëndët që realizohen në këtë program studimi fokusohen në formimin e punonjësit social. Në kurrikul janë përfshirë gjerësisht bazat e koncepteve të punës sociale. Ato mundësojnë, gjithashtu, zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 Plani mësimor;</i> <i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 14 Modeli i Syllabuseve;</i></p>





	<i>Evidenca 2.10 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përfundimi i studimeve në programin e ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social nuk mundëson punësim të menjëhershëm për të diplomuarit, sepse Ligji për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë Nr.10 171, datë 22.10.2009 (i ndryshuar), ku përfshihet edhe punonjësi social, lejon punësimin vetëm nëse studenti ka plotësuar 2 cikle të plota studimi Bachelor në Punonjës social dhe Master në një degë të specialitetit në Shkenca sociale, si dhe ka fituar licensën përmes Urdhrit të Punonjësit social për ushtrimin e profesionit.</p> <p>Në dokumentin “Disa të dhëna Alumni” (<i>Evidenca 5.6</i>) UE prezanton rezultatet e punësimin të ish-studentëve, ku përfshihen edhe ish-studentë të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët e DSHSEQ u konstatua se një pjesë e mirë e tyre kishin përfunduar studimet në këtë program studimi. Në takimet e realizuara në kuadër të vizitës në institucion, drejtuesit, por edhe pedagogët deklaruan se kanë kontakte me studentë të diplomuar në këtë program studimi, të cilët janë të punësuar në institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit apo edhe që ndjekin studimet Master në universitete të ndryshme europiane dhe më gjerë. Të dhëna të sakta në këtë drejtim mungojnë.</p> <p><i>Evidenca 2.8 Pyetësori Alumni</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Bazuar në të dhënat e mbledhura mund të thuhet se përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës brenda dhe jashtë vendit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për arritjen e objektivave formues dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, FSHE/DSHSEQ, si pjesë përbërëse e UE, dëshmojnë përmes dokumenteve “Lista marrëveshjeve të bashkëpunimit” (<i>Evidenca 1.12</i>) dhe “Lista marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave” (<i>Evidenca 1.13</i>) se kanë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjenci e biznese private, etj.</p> <p>Referuar dokumentit “Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022” (<i>Evidenca 3.9</i>), UE ka krijuar Bordin Këshillimor të Biznesit, ku janë përfshirë edhe studentët në aktivitete informuese për t’i njohur ata me kërkesat e punëdhënësve por që diskutimet e vizites në institucion nuk ka pjesëmarrës nga profesioniste të fushës së punës sociale.</p> <p><i>Evidenca 2.9 Plani Strategjik i Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit për vitin akademik 2020-2024; Evidenca 2.8 Pyetësori Alumni;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UNIEL nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatit Akademik UNIEL (<i>EVIDENCA 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL</i>). Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. (<i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor</i>).</p> <p>Institucioni mundëson monitorimin e punësimit të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një database për të parë se sa përputhet formimi që marrin me kërkesat e tregut të punës. (<i>Evidenca 2.8 Pyetësori Alumni</i>).</p> <p>Në FSHE/DSHSEQ gjenden praktika të mira të realizimit të pyetësorëve me studentët e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social (<i>Evidenca 2.8.1 Pyetësori me studentët</i>), por siç deklarohej edhe nga stafi akademik mund të bëhet më tepër në këtë drejtim. Bazuar në deklaratimet e autoriteve drejtuese të FSHE/DSHSEQ, stafit akademik dhe studentëve të programit të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social, pohohet se mundësohet përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit u lejon studentëve ruajtjen e anonimitatit gjatë dhënies së vlerësimit. (<i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor</i>)</p>





<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Referuar dokumentit “Propozim për ndryshime në planet mësimore” (Evidenca 2.5), por edhe dokumentit “Shkresë informuese projekti T@sk” (Evidenca 2,6; informacion plotësues-sjellë si informacion plotësues kërkuar nga GVJ) ku thuhet: “Impakti i projektit T@sk është evidentuar në përmirësimin e hartimit efektiv të kurrikulave dhe syllabuseve të disa disiplinave bazë të punës sociale si: “Hyrje në punë sociale”, “Vlerësimi i shërbimeve sociale”, “Supervizimi në Punë sociale” etj., dhe më tej “Në implementimin e projektit T@sk, Bashkia Elbasan ka qënë një partner i ngushtë i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”. Falë këtij projekti dhe bashkëpunimi u bë e mundur ndarja e praktikave më të mira të specialistëve të fushës kryesisht të punonjësve socialë që punojnë në Bashkinë Elbasan”, mund të dilet në përfundimin se Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar, struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, reflekton në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe partnerëve. (Evidenca 2.8 Pyetëtori Alumni)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar, struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor Punonjës Social, reflekton në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit duke marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>
---	------------------------------------	-----------------------------------	------------------------------------	-----------------





### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e studimit të FSHE”, neni 20 “Veprimtaritë formuese të programit të studimit” përcaktohet se: <i>“Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi në FSHE, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: mësim në auditor, si: leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private” (fq. 14).</i></p> <p>Referuar programeve lëndore të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, veçanërisht rubrikës “Format e kontrollit të dijeve”, vërehet se përveç testimit/provimit si një formë e vlerësimit të rezultateve të nxënit, theksi vihet në përfshirjen e metodave që sigurojnë aktivizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në diskutime, ushtrime praktike, detyra kursi individuale, esse, punë në grupe, angazhim në punë të pavarura kërkimore, prezantim të detyrave studimore, etj.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët dëshmohet se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet, seminarët dhe praktika profesionale, të cilat organizohen në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit, si: lojë me role, brainstorming, diskutim në grup, raste studimore, vëzhgime në situata praktike, refleksione, nxitje e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, prezantime në PowerPoint etj, duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën (informacion nga takimet në kuadër të vizitës në institucion). Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHE/DSHSEQ, konferenca studentore,</p>



	<p>trajtime si dhe në ëorkshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 23)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i FSHE/DSHSEQ ka përfituar ndër vite nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies në AL, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies në përgjigje të diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në AL, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Në dokumentin “Shkresë informuese projekti T@sk” <i>(Evidenca 2.6; informacion plotësues-sjellë si informacion plotësues kërkuar nga GVJ)</i> thuhet se:</p> <p><i>“Trajnimet e zhvilluara nga projekti T@sk për të aftësuar pedagogët e Punës Sociale në teknologjinë e mësimdhënies ndikuan në rritjen e kapaciteteve për të aplikuar metoda të reja në mësimdhënie, për të integruar suksesshëm teknologjinë në auditor dhe për ta bërë atë pjesë të mësimi”.</i></p> <p>Më tej në këtë dokument thuhet: <i>“T@sk me instrumentat e tij ka plotësuar nevojat e studentëve të Punës Sociale në Elbasan. Me krijimin e platformës MOODLE dhe rritjes së cilësisë së programeve akademike në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, projekti garanton rritjen e cilësisë së studentëve. Krijimi i infrastrukturës adekuate nëpërmjet laboratorit të Punës Sociale, dixhitalizimit të procesit mësimor dhe përfshirjes së studentëve në punë kërkimore, ëorkshope, trajnime dhe konferenca ka nxitur motivimin e studentëve të Punës Sociale... Studentët e punës sociale janë bërë pjesë e trajnimeve dhe konferencave, gjatë aktiviteteve që T@sk ka zhvilluar në UE. Aktivitete, të cilat kanë bërë të mundur përgatitjen e studentëve me dijet, aftësitë, profesionalizmin dhe kompetencat e duhura për të qenë të aftë në përmbushjen e kërkesave të tregut të punës sociale brenda dhe jashtë vendit. Gjatë tre viteve të projektit janë trajnuar gjithsej 149 studentë dhe 97 pedagogë”.</i></p> <p>Referuar komunikimit me stafin akademik gjatë vizitës në institucion mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnim në fushën e TIK për realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformës elektronike MOODLE dhe TEAMS, e cila vijon të shfrytëzohet nga stafi për komunikim me studentët, për detyrat</p>





	<p>me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime me grupe të vogla studentësh, etj, si një mundësi alternative e mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, që i përgjigjet diversitetit të nevojave të studentëve për të nxënë.</p> <p><i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+;</i>  <i>Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>FSHE/DSHSEQ si pjesë e UE-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Bazuar në RVB të programit të studimit të marrë në vlerësim deklarohet se: “UNIEL mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personeleve akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre.</p> <p><i>Në fq. 24 të RVB të programit të studimit të marrë në vlerësim deklarohet se: “Pjesëtarët e departamentit, në fillim të vitit akademik, por edhe në vijimësi, propozojnë aktivitete të mundshme që mund të organizohen gjatë vitit. Në këto aktivitete përfshihen workshop-e nga personel i ftuar apo personel i brendshëm, seminare, projekte etj. Orët e hapura dhe seminarët organizohen në lidhje me fushën e shkencave sociale”.</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+;</i>  <i>Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve” (fq. 18).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e</p>	<p>Referuar dokumentit “Aneks Tabela përmbledhëse” (<i>Evidenca 2.7 Tabela 1 dhe Tabela 2</i>) “Numri i personelit akademik i njësisë bazë” mësohet se:</p> <p><b>Nga 9 personel akademik efektiv (PAE)</b></p> <p>2 janë me titullin Prof/As;</p> <p>6 Dr;</p> <p>1 Msc;</p> <p><b>Nga 3 personel akademik me kontratë (PAK)</b></p> <p>1 Prof.Asoc;</p> <p>1 Dr;</p> <p>1 Msc;</p> <p>Rezulton raporti 9 me 3 (PAE/PAK) i cili është konform akteve nënligjore. Shumica e PA me kohë të plotë dhe të pjesshme mban grada e tituj shkencorë dhe një pjesë e tyre janë aktivë në fushën e publikimeve shkencore (CV-të e stafit akademik). Por</p>





marrëdhëniet të respektit të ndërsjellë mes tyre.

rezulton se vetëm 30 % e stafit është me të tre nivelet e formimit akademik në punë sociale dhe përsa i përket drejtuesit të programit, por edhe koordinatorëve të programit ata nuk i kanë të tre kualifikimet në punë sociale. Nga verifikimi i kualifikimit të stafit efektiv rezulton se vetëm 2 prej tyre kanë të tre ciklet e formimit në punë sociale; Angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike nuk justifikohet nga pedagogë të cilët nuk i përkasin drejtpërdrejtë fushës së punës sociale, në përputhje natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

*GVJ rekomandon që stafi i cili do të jetë i angazhuar në këtë program studimi të jetë tërësisht i formimit akademik në Punë Sociale, pasi dhe historiku i edukimit në këtë fushë në vendin tonë e mundëson një angazhim të tillë. Rekomandohet gjithashtu të shihet edhe ngarkesa mësimore e stafit akademik në këtë program, pasi disa pedagogë duke lektuar shumë lëndë (deri në gjashtë lëndë) çënojnë strukturimin, qëndrueshmërinë dhe disponueshmërinë e tij në zhvillimin e marrëdhënies cilësore akademike. Numri i lartë i lektimeve në disa lëndë mund të çojë në performancë të ulët dhe në pamundësi për thellimin në informacione të perditesuara dhe në orientimin drejt të studentëve drejt zhvillimeve. Orientohet që departamenti të tregohet i kujdesshëm në kohën dhe sasinë e lëndëve që një pedagog jep në këtë program studimi duke i kushtuar kështu më tepër rëndësi nevojave dhe aftësive të nxënësve.*


FSHE/DSHSEQ respekton procedura dhe kritere (të përgjithshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin “Rregullore e modaliteteve për punësimin e personelit akademik në UE” (Evidenca 4.2). Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit Bachelor në Punonjës social.

Bazuar në syllabuset lëndore të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, vërehet se titullarët e lëndëve/moduleve kanë përfshirë forma dhe metoda të mësimdhënies, të tilla si: diskutimi, punimi i detyrave individuale, ese reflektuese, studime rasti, etj, që inkurajojnë sensin e autonomisë së studentëve. Gjithashtu, FSHE/DSHSEQ mirëpret ushtrimin e të drejtës së studentit për ankimim, të sanksionuar në Rregulloren e FSHE (2020), Neni 44 “Ankimimi”, ku specifikohet se: “Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit....






	<p><i>Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar”.</i></p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se procesi i mësimdhënies dhe të nxënimit në FSHE realizohet në një klimë pozitive. Pedagogët respektojnë lirinë e mendimit të studentëve, duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë dhe të menduarit kritik e krijues të tyre. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të programit të studimit Bachelor në Punonjës Social</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, nga takimi me studentët u konstatua se në përfundim të lëndës/modulit personeli akademik realizon me studentët pyetësorë për vlerësim, ku meren parasysh mendimet dhe sugjerimet e studentëve për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 1.2Rregullore e studimeve UNIEL, neni 46</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UE në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionin e Përhershëm Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit të UNIEL;</li> <li>- Komisionin e Përhershëm Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit;</li> </ul>





<p>mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>- Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti;</p> <p>UE ka hartuar dokumentin standard të quajtur “<i>Realizimi i ngarkesës jashtë auditorit</i>” që përdoret nga drejtuesit e institucionit për të vlerësuar performancën e personelit akademik të UE në lidhje me angazhimin në procesin mësimor, punën kërkimore-shkencaore si dhe veprimtaritë në dobi të institucionit (konstatuar nga vizita në institucion).</p> <p>Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti është një strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ (funksionon si sektor, pjesë e Drejtorisë së Standardeve dhe Kurrikulave. <i>Evidenca 1.1, fq. 4.</i></p> <p>Sipas dokumentit “Statuti i UNIEL” (<i>Evidenca 1.1 Neni 71</i>), “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, kjo njësi ka në fokus: “<i>evidentimin e problematikave në lidhje me mësimin; evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies; sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies; vlerësimin periodic të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore; organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për cdo program studimi...</i>”.</p> <p>Komisioni i FSHE-së ka hartuar edhe një plan të veprimtarive (vënë në dispozicion në takimin e realizuar gjatë vizitës në institucion), por pranon se duhet të bëjë më tepër në drejtim të realizimit të vlerësimin të brendshëm të cilësisë. Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë.</p> <p><i>Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UE ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit të UNIEL; Komisionin e Përhershëm Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, të cilat kanë si funksion të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë</p>





	<i>dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në FSHE, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. FSHE ka hartuar “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020). Në kreun III të saj, “<i>Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi</i>”, përcaktohen kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve (<i>Evidenca 1.7</i>).</p> <p>Në kreun VIII të kësaj Rregulloreje, “<i>Diplomimi</i>”, përshkruhen procedurat e provimit final të diplomës për programet e studimit në FSHE. Në nenin 58, pika 3 thuhet se: “<i>Në programet e ciklit të parë të studimit, studenti diplomohet me provim përfundimtar formimi ose punim diploma. Ka të drejtë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, studenti i cili e mesataren e ponderuar të dy viteve të para të studimit e kanë jo më pak se 8 (tetë)</i>”.</p> <p>Për studentët të cilët zgjedhin sipas kriterëve përkatëse të mbrojnë temë diplome, UE/FSHE vendos në dispozicion të tyre një udhëzues të quajtur “<i>Manual për punimin e diplomës</i>” ku përshkruhet në mënyrë të detajuar metodologjia e punimit, struktura, etika e kërkimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike etj. (<i>Evidenca 3.10 Manual i punimit të diplomës</i>)</p> <p>DSHSEQ në dokumentin “Rregullore e Studimit të programit Bachelor në Punonjës Social” ka përcaktuar modalitete të provës finale për mbrojtjen e diplomës Bachelor në Punonjës Social, ku përshkruhen standardet lidhur me metodologjinë e punimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike dhe etikën e kërkimit etj. (<i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social</i>)</p>




	<p>DSHSEQ ka përgatitur paketën për realizimin e praktikës në institucion (<i>Evidenca 4.17.1 "Modeli dokumentet e praktikës"</i>), ku janë përcaktuar informacionet për institucionin ku realizohet praktika, pedagogun përkatës, modalitete për realizimin e praktikës në institucion, realizimin e praktikës vëzhguese, modalitete të vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervisorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve etj.</p> <p><i>Këto dokumente janë publike, por duhet te behen me të njohura nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe ndihmësakademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në dokumentin "Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE" (2020) (<i>Evidenca 1.7 neni 24</i>), pika 4 thuhet: "<i>Departamenti është i detyruar të vërë në dispozicion të studentëve programet lëndore të vitit akademik që frekuentojnë</i>".</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Bachelor në Punonjës social, në kategorinë "Forma e kontrollit të dijes dhe frekuentimi", është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve (<i>Programet mësimore të lëndëve të programit Bachelor në Punonjës Social</i>). Në fillim të çdo lënde, titullari i lëndës informon studentët rreth përmbajtjes së programit lëndor dhe mënyrës së testimit/vlerësimit. (<i>deklaruar nga stafi akademik në takimet gjatë vizitës në institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.</p> <p>Në dokumentin "Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social" (<i>Evidenca 1.8</i>) thuhet: "<i>Për lëndët që kanë në fund të semestrit provim këto pikë janë të ndara në 10% pikë për frekuentim të plotë, 10% në aktivizimin, realizimin e suksesshëm të detyrave të vëna, 30% nga rezultate maksimale të testeve për pjesë të caktuara sipas një grafiku që përcaktohet që në fillim të semestrit. 50% e pikëve sigurohen në provimin me shkrim dhe me gojë</i>".</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Bachelor në Punonjës Social, në kategorinë "Kontrolli i dijeve dhe</p>





	<p>vlërësimi”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohen gjatë gjithë vitit si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi, i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një segment të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlogaritet në rreth 50% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në notë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i Etikës i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (2020), Neni 5 “Liria akademike dhe kërkimore”, përcaktohet se: “Në UE respektohet liria akademike dhe kërkimore. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor ushtrohen në bazë të lirisë akademike dhe kërkimore.” Më tej, në Kreun III “Parimet e etikës gjatë veprimtarisë akademike, ndihmësakademike dhe studentore”, Neni 13 “Parimet e etikës gjatë veprimtarisë akademike thuhet: “Në UE veprimtaria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe shërben si bazë e vlerësimit të performancës së personelit akademik. Në UE personeli akademik ka detyrimin t’i përmbahet përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike; të realizojë me performancë të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv, duke zgjedhur metoda dhe mënyra efektive, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët”.</p> <p>Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson, dokumentin “Realizimi i ngarkesës jashtë auditorit” që përdoret nga drejtuesit e institucionit për të vlerësuar performancën e personelit akademik të UE-së në lidhje me angazhimin në procesin mësimor, punën kërkimore-shkencore si dhe veprimtaritë në dobi të institucionit (konstatuar nga vizita në institucion). Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë të të nxënësve përmes një ndërveprimi të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tregut të punës. Stafit akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që</p>





	mundësohet edhe nga institucioni. ( <i>Platforma Microsoft Teams, MOODLE</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	FSHE/DSHSEQ si pjesë e UE-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Bazuar në RVB të programit të studimit të marrë në vlerësim deklarohet se: <i>“UNIEL mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personeleve akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre.”</i>  <i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+;</i> <i>Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve” (fq. 18);</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion ve re se në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit dhe UE-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet

Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hap



gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.


Në dokumentin “Rregullore e studimit të FSHE” (Evidenca 1.7), kreu V “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi”, neni 37 “Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit” thuhet se: “Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimëve/provimeve me shkrim/ me gojë/ projekteve/ prezantimeve/ praktikave/ tezave të diplomave. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe vërteton përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të të nxënit.... Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar behet nga çdo pedagog dhe paraqitet për miratim pranë departamentit në fillim të vitit akademik”.

Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social” (Evidenca 1.8) thuhet: “Për lëndët që kanë në fund të semestrit provim këto pikë janë të ndara në 10% pikë për frekuentim të plotë, 10% në aktivizimin, realizimin e suksesshëm të detyrave të vëna, 30% nga rezultate maksimale të testeve për pjesë të caktuara sipas një grafiku që përcaktohet që në fillim të semestrit. 50% e pikëve sigurohen në provimin me shkrim dhe me gojë”.

Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Bachelor në Punonjës Social, në kategorinë “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi”, është përcaktuar se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohen gjatë gjithë vitit si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi, i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda. (Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit).



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi përmes sistemit elektronik “Microsoft Teams” është aplikuar vetëm në kushtet e pandemisë globale. Stafi akademik dhe studentët pohojnë se aktualisht sistemi përdoret për të marrë përgjigjet e vlerësimeve në një lëndë të caktuar, por jo për testim. UE ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me AADF për zbatimin e projektit CleanScore, në pikën 2 të të cilës në përshkrimin e projektit përcaktohet: <i>“Ofrimi i asistencës për rritjen e integritetit dhe transparencës në procesin e vlerësimit të studentit në arsimin e lartë duke përdorur teknologjinë CleanScore të siguar nga AADF”</i></p> <p><i>Evidenca 3.6 Marrëveshja për implementimin e CleanScore.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Bachelor në Punonjës Social, në kategorinë “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohen gjatë gjithë vitit si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi, i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një segment të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlllogaritet në rreth 50% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në notë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), Neni 42 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 4 përcaktohet se: <i>“Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni bën ballafaqimin me studentët ditën e caktuar të dhënies së rezultateve”</i>. Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale mund të shoqërohet me komente nga pedagogu përkatës (nëse është e nevojshme), për të sqaruar studentin dhe ndihmuar atë që të përmirësohet në të ardhmen. Kjo procedurë realizohet në kuadër të konsultave, të cilat janë të detyruara për pedagogun dhe realizohen menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli</p>	<p>Në dokumentin “Kodi i Etikës i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (2020), Neni 15 “Parimet e etikës gjatë</p>





<p>akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>veprimtarisë studentore” thuhet: <i>“Në UE studentët kanë detyrimin...Të mos kopjojnë në provime, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, të mos kopjojnë në punën kërkimore-shkencore të dikujt tjetër”.</i></p> <p>Në dokumentin “Manuali i punimit të diplomës” (Evidenca 3.10) thuhet: <i>“Punimi i shkruar në kuadër të programit Master duhet të jetë një kontribut i qenësishëm dhe original. Kjo detyrë bazohet në standarde rigorozë sa i përket metodologjisë, mënyrës së prezantimit dhe etikës së kërkimit”</i> (fq. 6).</p> <p>Në Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), Neni 42 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, Pika 12 përcaktohet: <i>“Anëtarët e komisionit të provimit të lëndës mbikëqyrin zhvillimin korrekt të tij. Në qoftë se gjatë zhvillimit të provimit, studentët në sallë ose persona të jashtëm nuk lejojnë kryerjen me rregull të tij, komisioni ka të drejtë të ndërpresë provimin dhe të kërkojë ndihmën e të gjitha instancave (deri tek organet e ruajtjes së rendit publik) për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit”.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>FSHE/DSHSEQ bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar. Në “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), Neni 37 “Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit” përcaktohet se: <i>“Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe vërteton përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të të nxënit”.</i> Më tej në nenin 39 “Sistemi i vlerësimit” thuhet: <i>“Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet me notë. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë)”.</i></p> <p>Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin “Forma e kontrollit të dijes dhe frekuentimi”, është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, të ndarë në kategori: masa e vlerësimit e shprehur në %, shkalla e pikëve, nota numerike, përshkrimi i notës. Zbatimi i një sistemi të detajuar pikëzimi tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të bazuara në meritë. Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik dhe ndihmësakademik shpjegoi se rezultatet e provimeve jepen në kohë sipas përcaktimeve në “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), Neni 42 “Mënyra e zhvillimit të provimit”, pika 4, që shprehet se <i>“Rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit”.</i></p>





**Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.


**Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.

UE/FSHE garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës. Rregullorja e organizimit të studimeve në UE, Neni 45 dhe "Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE" (2020), Neni 42 shprehën se *"Vlerësimet e studentëve pasqyrohen brenda 6 ditëve në Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të UE-së"*.

Në "Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE" (2020), neni 44 "Ankimimi" shprehet se *"Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, duke iu drejtuar dekanit të fakultetit. Dekani vlerëson ankesën dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Në rast se, nga shqyrtimi i ankimit, vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje, me propozimin e drejtuesit të departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit dhe për ridhënien e provimit ose kolokiumit brenda ditës ose të nesërmen. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si te pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të departamentit me një ankesë me shkrim. Drejtuesi i departamentit vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe, me urdhër, ngarkon një komision "ad hoc" (në përbërje të të cilat janë anëtarët e komisionit të provimit, por edhe pedagogë të tjerë) që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Vendimi që merr ky komisioni "ad hoc" mbi rivlerësimin e provimit është i formës së prerë dhe depozitohet në departament dhe në sekretarinë mësimore. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem"*.

Në nenin 47 të Rregullores "Përmirësimi i notës" përcaktohet se: *"Studenti ka të drejtë të përmirësojë çdo vit akademik vetëm dy nota gjatë sezonit të vjeshtës. Studenti mund të përmirësojë vetëm notat për lëndët e vitit akademik që frekuenton. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Dekanit, jo më vonë se një javë para fillimit të sezonit të vjeshtës. Përmirësimi i notës mund të bëhet vetëm një herë. Në këtë rast, notë përfundimtare do të konsiderohet nota e marrë në rivlerësim"*

Neni 43 "Korrigjimi i gabimit material të notës thekson se: *"Një notë e raportuar në sistem (në procesverbalin e gjeneruar të sistemit) mund të ndryshojë/korrigjohet vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim material gjatë hedhjes (ngarkimit) në sistem. Për këtë qëllim, pedagogët e Komisionit duhet të*





	<p><i>dorëzohen një proces-verbal me shkrim ku justifikohet gabimi material. Proces-verbali miratohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Dekani i FSHE-së. Ndryshimi/korrigjimi i gabimit material pranohet, si rregull, vetëm brenda periudhës kohore që sistemi qëndron i hapur dhe mundëson ndryshimin (editimin) e notave. Nëse gabimi konstatohet pas kësaj periudhe, korrigjimi i gabimit material të notës në sistem, bëhet vetëm pas miratimit nga Rektori dhe rihapjes së sistemit nga administratori në Rektoratin e UE-së. Kur shfaqen paqartësi në lidhje me ndonjë gabim të mundshëm të një note të paraqitur nga pedagogë, të cilët nuk janë më pjesëtarë të trupës mësimore, Dekani i FSHE-së ngre një komision të posaçëm për të zgjidhur problemin dhe autorizon ndryshimin e mundshëm”.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UE/FSHE garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës dhe FSHE/DSHSEQ bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje të pjesshme</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Program i studimit Bachelor në Punonjës Social është dizenuar për të përgatitur studentët për arsimim të mëtejshëm. Programi i studimit “Bachelor në Punonjës Social” i prezanton studentët me mundësi për të eksploruar dhe thelluar njohuritë nga disiplina të ndryshme të fushës së punës sociale. Sipas dokumentit “Model diplome-Suplementi i diplomës” theksohet se: “Ky program studimi synon të përgatisë specialistë të punës sociale, me njohuritë bazë të domosdoshme dhe integruese për ciklet e tjera të studimit; t’u japë studentëve njohuri bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aftësi specifike në një gamë të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>




	<p>Ky program studimi orienton studentët edhe drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse me tregun e punës. Programi realizohet nga një staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj akademik, si dhe me përvojë në fushën e kërkimit dhe praktikave të shërbimit të punonjësit social (<i>CV e personelit akademik për programin e studimit</i>).</p> <p>Programi siguron lidhjen e teorisë me praktikën duke ballafaquar dhe familjarizuar studentët me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. Programi zhvillohet në mjedise me një infrastrukture të përshtatshme, të pajisur me teknologji që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore, mbështetur me internet dhe eirles, me biblioteke të pasur me libra fizikë dhe burime online. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe mënyra se si ky program zhvillohet/ofrohet nga FSHE/DSHSEQ, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. <i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 10 Plani mësimor BaPS;</i></p> <p><i>Evidenca 2.10., Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Punonjës Social;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Institucioni dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit të studentëve për të përdorur sistemin MOODLE apo Microsoft Teams për qëllime mësimore. Në Programin e studimit Bachelor në Punonjës Social është përfshirë semestrin e parë të vitit të parë të studimeve lënda “TIC (SPSS)” si një lëndë dedikuar zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit Gjithashtu, programi mundëson studentët të përdorin teknologjinë bashkëkohore dhe të zhvillojnë aftësitë për të komunikuar e ndërvepruar në funksion të arritjes së objektivave mësimorë teoriko- praktikë dhe studimore. Programi përfshin “Gjuhën e huaj”, e cila zhvillohet si lëndë e detyruar për të gjithë studentët me shtrirje gjithëvjetoare në vitin e parë të studimeve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>DSHSEQ, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të vitit akademik, DSHSEQ kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundshme përfshihen në raportin e analizës</p>





<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>vjetore të DSHSEQ. (<i>Evidenca 1.14 Analiza Vjetore e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar</i>).</p> <p>Bazuar në dokumentin standard të hartuar nga institucioni “Realizimi i ngarkesës jashtë auditorit”, por edhe nga takimi me stafin akademik në institucion, GVJ mësoi se pedagogët e çdo lënde në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizojnë seanca konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orientojnë studentin për provimin përfundimtar. Këto konsultime janë të përfshira në ngarkesën e pedagogut deri në masën 30 orë. Gjithashtu, në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/në grup), të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca 2.7 Aneks Tabela 14 Syllabusi i lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Punonjës Social, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritshme të të nxëniet që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor (<i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i>).</p> <p>Referuar dokumentit “Analiza vjetore e DSHSEQ” (2020-2021 dhe 2021-2022), si dhe në dokumentin “Analiza vjetore institucionale 2020-2021” vërehet se stafi akademik ka përfituar dhe është angazhuar në ngjarje të ndryshme shkencore, të cilat janë realizuar në UE/FSHE përgjatë vitit akademik, të tilla si: konferenca, simpoziume, ëorkshope, seminare shkencore, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, tavolina të rrumbullakëta, veprimtari promovuese, etj. (<i>Evidenca 1.11 dhe Evidenca 1.14</i>).</p> <p>Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: lojë me role, punë në grupe, analiza, reflektim dhe diskutim mbi raste klinike/raste studimore, etj. (<i>Evidenca 2.9 Syllabuset e lëndëve</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>






kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në programet lëndore/syllabuset, në kategorinë “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, vërehet se shumica e titullarëve të lëndëve kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxënit e studentëve të bazuar në diskutimet, studimet e rastit, punën në grup dhe nxitjen e mendimit kritik dhe kreativ në përvetësimin e dijeve, interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën  <i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Evidenca 5.2 Kalendari i ditëve-të hapura 2022</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi siguron lidhjen e teorisë me praktikën duke ballafaquar dhe familjarizuar studentët me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. Programi zhvillohet në mjedise me një infrastrukture të përshtatshme, të pajisur me teknologji që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore, mbështetur me internet dhe eirles, me bibliotekë të pasur me libra fizikë dhe burime online. Lidhur me aspektin metodologjik të mësimdhënies, studentët dhe pedagogët shpjeguan gjatë vizitës në institucion se leksionet, seminarët dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke u dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	FSHE ka hartuar procedura të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Në dokumentin “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020) Kreu VIII “Diplomimi” përshkruhen hollësisht modalitetet e realizimit të provimit final ose mbrojtjes së diplomës. Në nenin 58, pika 3 thuhet se: “Në programet e ciklit të parë të studimit, studenti diplomohet me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Ka të drejtë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, studenti i cili e mesataren e ponderuar të dy viteve të para të studimit e kanë jo më pak se 8 (tetë)”.





	<p>Po ashtu, UE/FSHE vendos në dispozicion të studentëve udhëzuesin “Manual për punimin e diplomës” ku përshkruhet në mënyrë të detajuar metodologjia e punimit, struktura, etika e kërkimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike etj. (Evidenca 3.10 Manual i punimit të diplomës)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>FSHE/DSHSEQ, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. FSHE ka publikuar “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020) ku në kreun VIII “Diplomimi” përshkruhen hollësisht modalitetet e realizimit të provimit final ose mbrojtjes së diplomës. Për studentët, të cilët zgjedhin sipas kritereve përkatëse, të mbrojnë temë diplome, UE/FSHE/DSHSEQ vendos në dispozicion të tyre “Manual për punimin e diplomës” ku përshkruhet në mënyrë të detajuar metodologjia e punimit, struktura, etika e kërkimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike etj. (Evidenca 3.10 Manual i punimit të diplomës)</p> <p>FSHE/DSHSEQ ka caktuar një koordinator të programit të studimit (Evidenca 2.4 Përcaktimi i koordinatorëve të programit të studimit BaPS), i cili është përgjegjës për të monitoruar ecurinë e ndërveprimit të studentëve me pedagogët udhëheqës përkatës, si dhe sigurimin që studentët disponojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për zhvillimin e provimit final të diplomimit, DSHSEQ ndjek procedura të parashikuara në “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020) ku në kreun VIII “Diplomimi”, neni 62 thuhet se “Në FSHE organizohen tre sezona për provimin përfundimtar të formimit: në verë, vjeshtë dhe dimër. Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga dekani i fakultetit sipas strukturës mësimore të vitit akademik përkatës, të miratuar në fillim të çdo viti akademik. Programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Drejtuesi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në ëëbsite-n e UE-së, dhe u bëhet i ditur studentëve në fillim të vitit të fundit të studimeve, sipas programit të studimit. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit.</p>





	<p><i>Pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i fakultetit”.</i></p> <p>Më tej në nenin 63 “Mbrojtja e diplomës” thuhet: <i>“Mbrojtja e diplomës me provim të përgjithshëm përfundimtar bëhet para një komisioni të përbërë prej 3-5 pedagogë, të propozuar nga drejtuesi i departamentit dhe miratuar nga dekani i fakultetit”.</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIUEL, neni 63;</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, neni 63;</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BaPS, nenet 26-37;</i></p> <p><i>Evidenca 3.14 “Model propozimi i komisionit të provimeve;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit të marrë në vlerësim tregon se siguron një rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët me konsultime, nëse ata kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndët e tyre.</p> <p>Përsa i përket përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës, personeli akademik, i cili udhëheq studentin njeh dhe zbaton përcaktimet e “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), Kreu VIII “Diplomimi”, Neni 63, si dhe udhëzimet dhe përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në këtë veprimtari, të parashikuara në “Manual i punimit të diplomës” (<i>Evidenca 3.10 Manual i punimit të diplomës</i>) si dhe përcaktimet në “Kodi i Etikës i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (2020), Neni 13 “Parimet e etikës gjatë veprimtarisë akademike” si dhe neni 15 “Parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore”.</p> <p>Sipas “Manual i punimit të diplomës” pedagogut udhëheqës i kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së punimit;</li> <li>-të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që të mundësojë kandidatin të arrijë standarde të larta të punimit;</li> <li>- të mbajë takime të rregullta me studentët) për të dhënë këshilla dhe për të qënë në dijeni të ecurisë së punimit;</li> <li>- të vlerësojë progresin e studentit rregullisht;</li> </ul>





	<p>-të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar;</p> <p>-të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin etj. <i>Evidenca 3.10 Manual i punimit të diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FSHE/DSHSEQ asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore. FSHE si pjesë e UE, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, qendra të shërbimit social, agjenci e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat krijojnë mundësi jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe për realizimin e punimeve studimore nga ana e studentëve.</p> <p>FSHE/DSHSEQ asiston studentët brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar seanca metodologjike, konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në bibliotekë, mjedis të mbuluar me Ëi-Fi. (<a href="https://www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion/1082-uniel-manual-per-punimin-e-diplomes">https://www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion/1082-uniel-manual-per-punimin-e-diplomes</a>)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në përcaktimet e “Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE” (2020), kreu V “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi”, neni 37 “Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit” thuhet se: <i>“Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë)”</i>.</p> <p>Më tej, në kreun VIII “Diplomimi”, neni 61 “Organizimi i provimit të formimit” përcaktohet se: <i>“Vlerësimi përfundimtar i provimit të formimit pasqyrohet në procesverbalin përkatës dhe Sistemin e menaxhimit të të dhënave”</i> dhe në nenin 63: <i>“Vlerësimi i punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës dhe Sistemin e menaxhimit të të dhënave. Në përfundim të procesit, Kryetari i Komisionit hedh rezultatin e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Procesverbali i gjeneruar nga sistemi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit i përgjithshëm përfundimtar”</i>.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 65; Evidenca 1.7 Rregullore e FSHE, neni 63;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për</p>



<p>miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, shoqërohen me suplementin e diplomës. Çdo formë diplome dhe certificate, përpara se të lëshohet nga UE, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohet në statutin e UE-së, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit. Si rregull, tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, i cili nënshkruan në regjistrin përkatës. Nëse i diplomuari, e ka të pamundur të paraqitet personalisht për të tërhequr diplomën, në këtë rast tërheqja e diplomës mund të bëhet nga një person i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur dokumentin e identifikimit”.</p> <p>Në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Punonjës Social, studentit i vihet në dispozicion: diploma dhe suplementi i diplomës, si dhe një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, nëse ai e kërkon. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 66;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FSHE, neni 64;</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UE/FSHE ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FSHE disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 67;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FSHE, neni 65;</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik i programit të studimit të marrë në vlerësim tregon se siguron një rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët me konsultime, nëse ata kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndët e tyre.</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																														
<b>Kriteri 1.</b> . Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Punonjës Social”, bazuar në (tabelat 6.1 – 6.3 Evidencav 2.7) është:																																														
	1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 3 PAK (84 % /16 %);																																														
	2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 3 PAK (85 % /15 %);																																														
	3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 3 PAK (85 % /15 %);																																														
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>9</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td><b>Në total</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>17</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>17</b></td> <td><b>3</b></td> </tr> </tbody> </table>							Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.As.Dr	5	1	5	1	5	1	Dr/PhD	9	1	10	1	10	1	Msc	2	1	2	1	2	1	<b>Në total</b>	<b>16</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>3</b>	<b>17</b>
Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020																																										
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																									
Prof.As.Dr	5	1	5	1	5	1																																									
Dr/PhD	9	1	10	1	10	1																																									
Msc	2	1	2	1	2	1																																									
<b>Në total</b>	<b>16</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>3</b>																																									




	<p>Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik për të 3 (tre) vitet akademike rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>85%</b> e pedagogëve kanë gradë shkencore /tituj akademik, 15% janë Msc;</li> </ul> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se vetëm 30 % e stafit është me të tre nivelet e formimit akademik në punë sociale dhe përsa i përket drejtuesit të programit, por edhe koordinatotëve të programit ata nuk i kanë të tre kualifikimet në punë sociale. Nga verifikimi i kualifikimit të stafit efektiv rezulton se vetëm 2 prej tyre kanë të tre ciklet e formimit në punë sociale; duke mbajtur në fokus se edukimi në punë sociale ka startuar në vitin 1992 dhe moshë mesatare e PAE nuk justifikon diplomimin në disiplina të tjera duke cënuar kështu mësimdhënien në punë sociale. Angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike nuk justifikohet nga pedagogë të cilët nuk i përkasin drejtpërdrejtë fushës së punës sociale, në përputhje natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p><i>Rekomandohet që stafi i angazhuar në këtë program studimi të jetë i kualifikuar me gradë shkencore doktoraturë në punë sociale dhe histori të evidencave të suksesit në mësimdhënie. Gjithashtu të demonstrojnë motivim për të përkrahur studentët në fushën e kërkimit në punë sociale duke u fokusuar në sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen komunitetet dhe individët në nevojë duke bashkëpunuar edhe me kolegët e tjerë të punës sociale; duke garantuar kështu një mjedis mësimor të përkushtuar dhe të efektshëm që mundëson kapërcimin e sfidave studentore në këtë fushë kaq të rëndësishme për shoqërinë.</i></p> <p>GVJ gjykon se stafi me kualifikime në disiplina të tjera mund të jetë i angazhuar në lëndët e disiplinave C dhe D (lëndë ndërdisiplinore/ integruese apo Lëndë plotësuese) por jo në lëndë karakterizuese pasi kështu çenohet formimi i profesionistëve.</p> <p><i>Evidenca 2.7 tabela 6.1-6.3;</i></p> <p><i>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 lëndët dhe ngarkesa përkatëse.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi (Vendimit Nr. 418, datë 10.5.2017) dhe një përllogaritje e orëve</p>






<p>studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>në auditor rezulton se nga 2056 orë në total për këtë program 1586 orë lektohen nga PAE (77.14%).</p> <p>Referuar Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, II, pika 1 “Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor në IAL”, specifikohet se orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe me raste specifike ka të përcaktuar procedurën, ndërkohë nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se PAE i angazhuar në këtë PS mbulon orë mësimore që variojnë nga minimum 238 orë mësimore në maksimumin 450 orë mësimore duke tejkaluar mbingarkesën e 200 orëve suplementare; dhe në të gjithë rastet stafi është i mbingarkuar duke tejkaluar mësimdhënien e normuar, kjo referuar evidencës për realizimin e orëve vjetore për vitin akademik 2021 – 2022.</p> <p>Edhe ngarkesa në orë mësimore e Dekanes së Fakultetit në këtë program është e mbinormuar (377 orë në auditor). Referuar Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, pika 6.”Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale <i>Masivisht i gjithë stafi është me 6 lëndë semestrale, por gjenden pedagogë si V.M me 7 lëndë semestrale dhe 1 praktikë; E.H 7 lëndë semestrale dhe 2 praktika; S.B. 7 lëndë semestrale; Z.G. 7 lëndë semestrale (Ref tabela 4)</i></p> <p><i>GVJ gjykon që për një pjesë të PAE ngarkesa është e lartë dhe moszotërimi i dijeve në punë sociale mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e punonjësve socialë profesionistë.</i></p> <p><i>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022 lëndët dhe ngarkesa përkatëse;</i></p> <p><i>Evidenca 1.14 Analiza e Departamentit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime</p>	<p>Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata paafat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, si dhe i angazhuar në këtë program që prej ditës së parë që programi është hapur, e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënien në këtë program. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet DBNJPA ndjek në mënyrë rigoroze procedurat në bashkëpunim me Departamentet. IAL, me vendim Senati Nr.23, datë 12.10.2020,</p>






<p>shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>ka miratuar modalitetet për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik në UE, si dhe zbaton një rregullore për rekrutimin e stafit (Vendim Senati Nr.33, datë 06.07.2018, “Për caktimin e modalitetet për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit ndihmësakademik në UE”; si dhe Vendimin e Senatit Nr.12, datë 23.01.2019, “Për miratimin e modaliteteve për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit administrativ në UE”; të cilat kanë për qëllim të përcaktojnë kushtet që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015, Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi.</p> <p>Nga vizita në institucion u konfirmua prezenca e kontratave për përsonein efektiv dhe atë të jashtëm të DSHSEQ, si dhe pagesa e rregullt e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti, Kreu VI, nenet 38-41;</i></p> <p><i>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik në UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmësakademik në UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.4 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit administrativ në UNIEL;</i></p> <p><a href="https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1311-rregullore-per-caktimin-e-kritereve-dhe-procedurave-per-punesimin-e-personelit-akademik-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani">https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1311-rregullore-per-caktimin-e-kritereve-dhe-procedurave-per-punesimin-e-personelit-akademik-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësues dhe administrativ. I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit konform kritereve të shpallura ndiqet dhe vlerësohet nga drejtoria e specializuar për këtë proces DBNJPA, e fillon procesin pasi merr kërkesën nga DSHSEQ (njësia bazë). Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL ose në faqe të agjencive ndërkombëtare. Aplikimet bëhen me dokumentet përkatëse (originale ose të noterizuara) në adresën e publikuar në shpalljen e vendit të lirë të punës dhe përzgjedhja bëhet nga një komision bëhet me konkurs. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga rektori. Rektori krijon komisionin <i>ad hoc</i> për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë, ndërsa dekani krijon komisionin <i>ad hoc</i> për konkursin e punësimit të</p>





	<p>personelit akademik me kohë të pjesshme, bazuar në propozimin e drejtuesit të njësisë bazë. Komisioni <i>ad hoc</i> vlerëson dhe rendit kandidatët konkurrues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UNIEL. Komisioni <i>ad hoc</i> propozon renditjen përfundimtare. Ankesat në lidhje me vlerësimin dhe zbatimin e procedurave nga komisioni <i>ad hoc</i> paraqiten brenda 10 ditëve të rektori. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës.</p> <p>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, Kreu VIII,</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Format stafit akademik;</i></p> <p><i>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik në UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmësakademik në UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.4 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit administrativ në UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UNIEL siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij.</p> <p>Në nenin 33 të Rregullores së UE-së janë përcaktuar laboratorët dhe funksionet dhe kompetencat e laboratorit.</p> <p><i>Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmësakademik në UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.4 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit administrativ në UNIEL</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, Kreu VIII</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.10 Struktura organizative e UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkiv (DBNJPA), përgatit dhe ruan përshkrimet e punës, bashkëpunon me Rektoren dhe Administratorin për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar si dhe ndjek zbatueshmërinë e procedurave të punësimit të personelit të UE-së deri në firmosje të kontratës së punës, kjo zyrë ruan të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet</p>





<p>përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore;</p> <p>GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p>Nuk ka të dhëna që dëshmojnë që DSHSEQ bashkëpunon me departamente të tjera në FSHE si edhe angazhimin në mbulimin me pedagogë të brendshëm të fakulteteve të tjera në UE që mbulojnë lëndë specifike, sipas profilit brenda programit të studimit (ka bashkëpunim me të punësuar në UT, Spitalin Psikiatrik dhe me një Msc. E.D. të shkollës 9 vjeçare “Sule Harri”). Nga analiza e ngarkesës totale të personelit akademik nuk rezultoi një profilizim i pedagogëve të cilët njëkohësisht lekojnë edhe lëndët e punës sociale me fëmijët edhe ato me pakicat kombëtare, grupet e riskut HIV, gjë e cila sygjerohet të riorganizohet në një numër më të reduktuar ekspertizash për stafin pedagogjik.</p> <p><i>Evidenca 2. 7; Tabela 4, 6.1, 6.2, 6.3, 12.1, 12.2, 12.3;</i></p> <p><i>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021 -2022;</i></p> <p><i>Evidenca 6.4 Lista e personelit të fuar të angazhuar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit;</i></p> <p><a href="https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/drejtore/drejtoria-e-burimeve-njerezore-dhe-protokoll-arkives">https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/drejtore/drejtoria-e-burimeve-njerezore-dhe-protokoll-arkives</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentojmë një Model Marrëveshjeje Bashkëpunimi për zhvillimin e praktikës në institucione, ndërmjet Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe specifikisht të Departamentit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit Qytetar, por vetëm modelar, jo marrëveshje të nënshkruara me institucione specifike. Referuar raportit të GVB-së të institucionit gjendet një listë me marrëveshje por ajo është e paaksesueshme edhe gjatë kërkesës për dokumentacion shtesë ajo nuk na u mundësua (<i>EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.docx</i>).</p> <p>Nuk kemi dhe evidenca të mjaftueshme apo dokumentacion për të gjykuar mbi personelin e duhur e të kualifikuar të cilën kompania me të cilën është lidhur marrëveshja vë në dispozicion për mbikëqyrjen e studentëve në realizimin e praktikës. Referur materialit Udhëzues për praktikën, të Projektit T@SK (<i>Evidenca 4.18</i>) të vënë në dispozicion nga GVB vlen të theksohet se ai nuk është i plotë, është në anglisht</p>





	dhe referuar gjuhës së programit shqip bëhet i papërdorshëm dhe i paaplikueshëm nga studentët.			
	<i>Evidenca 4.17 Marrëveshje për praktikën;</i>			
	<i>Evidenca 4.18 Projekti T@SK Udhëzues për praktikën;</i>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të njohur apo evidentuar personelin mbikqyrës në ambientet ku realizohet praktika profesionale e studentëve. gjithashtu nuk gjenden as detyrimet përkatëse të këtij personeli në ndihmën ndaj studentëve për përmbushjen e detyrimeve për plotësimin e praktikës profesionale.  GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët, të cilët duhet të ishin në javën e parë të praktikës konstatoi se ata ende nuk ishin vendosur të gjithë nëpër institucionet për realizimin e praktikës dhe shprehnin shqetësim për mungesën e asistimit të tyre për realizimin e praktikave profesionale, për vendosjen në institucione, ku në disa raste nuk ndiheshin të mirëpritur.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e përshtatshëm akademik, edhe pse jo tërësisht në përputhje me programin "Punonjës Social", por në pjesën më të madhe në fusha të përafërta me të, gjithashtu në shumicën e tij stafi është i mbingarkuar me orë mësimore në auditor dhe shumë nga lëndët karakterizuese të programit lektohen nga personel akademik jo tërësisht i kualifikuar në punë sociale, duke cënuar disi garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	


#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për	IAL e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet



<p>zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>përkatëse. Godina ku gjendet Fakulteti Edukimit dhe zhvillon mësimdhënien e PS, DSHSEQ ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (134 në të tre vitet) që ka aktualisht. Sipërfaqja m<sup>2</sup>/për student është 2.55. Gjithashtu referon se ka edhe Akt miratimi Higjienosanitar Nr. 25 datë 09.04.2014 dhe Akt Teknik Mbrojtje nga zjarri Akt Kontrolli Nr. 10 datë 21.09.2016, të cilët sygjerojmë të ronovohen me data më të afërta. GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambjent të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Gjithashtu u konstatua që infrastruktura e UNIEL krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse në godina të të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p><i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e FSHE;</i></p> <p><i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve në FSHE;</i></p> <p><i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Bibliotekës UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHE Anexx 4.9 Të dhëna mbi infrastrukurën e FSHE;</i></p> <p><i>Tabela 16; Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë 4 4041.7 m<sup>2</sup>/1587 studentë= 2.55 m<sup>2</sup>/student)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore</p>	<p>Mjediset mësimore të ofruara nga FSHE janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. FSHE siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit. Mjediset mësimore, auditorët, janë modeste me tabela apo dërrasa dhe ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si videoprojektor dhe PC), përveçse në sallat e laboratorëve.</p>





<p>të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Rrjeti i internetit është shtrirë në të tri katet, në sallat kompjuterave dhe në të gjitha zyrat. Sipas raportit të RVB-së në godinen e FSIIE-së ndodhen 6 laboratore mësimore, një prej të cileve është laborator IT për zhvillimin praktik të mësimdhënies, referuar Evidencës 4.7 rezulton se në katin përdhe gjendet një Laborator vizatimi dhe një Laborator psikologji/QKZHE dhe në katin e parë gjendet laborator muzike, laborator vizatimi, dhe sërish laborator muzike, dhe për programin që akreditohet ka një laborator të dedikuar nga projekti T@sk.</p> <p>Klasat dhe auditoret e FSIIE-se janë të pajisura infrastrukturen e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në perputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies siç është sistemi MOODLE, TEAMS, LMS, sistemi që mundësojnë perditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në perputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. Më shumë se 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme. GVJ pati mundësinë të vizitonte edhe një klasë të pajisur me teknologji nga projekti T@sk, në funksion të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit;</i></p> <p><i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Bibliotekës UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të FSHE;</i></p> <p><i>Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të FSHE)</i></p> <p><i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.pdf, ndërkohë në RVB thuhet se</i></p> <p><i>Evidenca 4.11.1 Urdher mbi zbatimin e platformes LMS (Rc/ Ivr. 46./, UE-LMS. Guide per pedagogun;</i></p> <p><i>Re/ Ivr. 46.2/, UE_LMS Guide per studentet /Re/ Nr. 46.3</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e</p>	<p>Programi i studimit punonjës social i referohet një shkence të aplikuar ndaj ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik, i cili këshillohet të realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës profesionale në institucione. nga analiza e programit</p>





nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	mësimor rezultojnë e përfshirë praktika profesionale, edhe në formën e seminareve edhe në praktikën në institucione. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovizuale, interanti apo edhe dërrasat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili ishte i pajisur me programet profesionale, e ndërmjetësuar nga një projekt (T@sk) ku DSHSEQ është pjesëmarrës. laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe fushës së studimit në punë sociale.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës UNIEL, ajo ka një fond prej 23632 libra dhe 69410 kopjesh, por nuk evidentohet përshtatjen e këtyre teksteve me programin specifik të punonjës social. Gjithashtu anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor.  Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit Bachelor. Ka përpjekje për të garantuar literaturë



	<p>bashkëkohore të dedikuar programit të punonjësit social nga projekti T@SK por dhe kjo në gjuhë të huaj, por vlen të përmendet se një pjesë jo shumë e rëndësishme e kësaj literature reflektohet në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme e autorëve dhe e tekseve bazë të punës sociale nuk rezultojnë në listat e librave të vëna në dispozicion</p> <p><i>Nga vizita në institucion rezulton se numri i titujve në fushën e punës sociale në bibliotekën e Fakultetit dhe atë të UE është shumë i limituar, gati i papërfillshëm.</i></p> <p>Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 3.8.1 Fondi i librave T@SK;</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Fondi i librit;</i></p> <p><i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia pasyron kërkesat e saj për literaturë propozimet e planifikimit të buxhetit për vitin pasardhës, por referuar buxhetit jo përherë kërkesat e saj merren në konsideratë dhe plotësohen, Nuk gjendet një raport mbi përditësimin dhe nga lista e librave të cilët gjenden në Bibliotekën FSHE dhe në atë Qendrore nuk evidentohen libra shqip të viteve të fundit.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që UE ka shtuar fondin e librave në fushën e biznesit me 24 tituj të rinj në periudhën 2017-2020. Kërkesa është bërë nga personeli akademik i departamentit të Administrim Biznesit. Fondet e librave mund të shtohen edhe përmes donacioneve, por IAL nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë për ta verifikuar këtë procedurë.</p> <p><i>Gjithashtu nga vizita në bibliotekë nuk u evidentuan tekstet në shqip të dedikuara punës sociale në kohëve të fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dy biblioteka, një bibliotekë qendrore në ambientet pranë zyrave qendrore të rektoratit dhe një bibliotekë në ambientet e FSHE-së, me sipërfaqe 64.8 m2.</p> <p>Të dy bibliotekat janë lehësisht të aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. GVJ vizitoi bibliotekën dhe konfirmoi që ambienti ishte i hapur me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Fondi i librave është i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Studentët kanë të drejtë të huazojnë libra dhe t'i mbajnë ato deri në 15 ditë dhe maksimumi i tekseve që mund të marrin njëkohësisht është 3.</p>





	<p><i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit;</i></p> <p><i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Bibliotekës UNIEL.xlsx</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar fondit të librave sipas evidencave të prezantuara ai është mëse i mjaftueshëm dhe gjykojmë për një fond fizik të mjaftueshëm por jo të përshtatshëm plotësisht për modulet e programit punë sociale.</p> <p>Nga konsultimi i listave të fondit të librave në shqip, të vëna në dispozicion gjatë vizitës në institucion <i>ka shumë libra por kryesisht ata janë ose të natyrës psikologjike ose filozofike dhe sociologjike, të cilat janë të nevojshme dhe shumë të lidhura me punën sociale por jo drejtpërdrejt të punës sociale.</i></p> <p>Nga takimi me studentët ata na konfirmuan se literatura e detyrueshme e lëndës, por dhe materiale të tjera shtesë ju viheshin në dispozicion nëpërmjet platformave dixhitale të ndërveprimit. <i>Evidenca 3.8 Fondi i librit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përdorimi i fondit të librave të bibliotekës është i mundur nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe kërkues. Me anë të kredencialeve zyrtare ata mund të aksesojnë në çdo moment edhe binlioteken online. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi që UNIEL ka anëtarësim të plotë në JSTOR. Çdo anëtar i personelit akademik ka akses në koleksionet e JSTOR U-Library dhe mund të aksesojnë disa artikuj në mënyrë periodike. Studentët gjithashtu mund të kërkojnë libra ose mund të kenë akses në artikuj e botime të ndryshme nga JSTOR duke shkuar në <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Aktualisht biblioteka ka pajisje elektronike dhe akses në internet, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. Fondi i bibliotekës është i gjithi digjitalizuar dhe studentët mund të konsultojnë gjithashtu edhe bibliotekën online "U-Library"</p> <p>(<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>.)</p> <p>GVB konfirmon se Biblioteka Qendrore e Universitetit është duke iu nënshtruar procesit të dixhitalizimit të saj, e pajisur me programe nëpërmjet një projekti të bashkefinancuar nga AKKSH dhe UNIEL</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që orari i bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit është çdo ditë të javës 08:00-16:00 dhe biblioteka kryesore vihej në</p>



<p>në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>dispozicion të studentëve në oraret E Hënë - E premte 08:00-19:00 dhe ditën E Shtunë: 08:00-16:00.</p> <p>Oraret e shërbimit janë të përshtatshme për studentët e këtij programi studimi. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë.</p> <p><i>Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga analiza vjetore institucionale (fq.108) vihemi në dijeni se fondi i librit është realizuar me vlerë 1,101 mijë lekë dhe kontrata është regjistruar në Degën e Thesarit si obligime në SIFQ për vitin 2021.</p> <p>Po nga treguesit analitik informohemi se pajisjet (inventor ekonomik) ku bën pjesë edhe fondi i librit dhe biblioteka janë realizuar në masën 88.1 %.</p> <p><i>Nuk gjenden raporte të tjera analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online.</i></p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e cila duhet marrë vëmendje nga njësitë bazë, të analizohet dhe të ndërtohen plane konkrete veçanërisht për fondin fizik të librit shqip,, pasi kështu mund të mundësohet pasurimi i fondeve dhe përditësimi i literaturës në punë sociale, e cila është domosdoshmëri për procesin e formimit teorik të studentëve në punë sociale. Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies në mjediset e institucionit (bibliotekë apo sallën laborator).</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit institucioni përdor sistemin EMS, e cila është një platforme elektronike nëpërmjet të cilës krijohen, shikohen, përditësohen dhe fshihen të dhëna për personelin e UE-së dhe studentët që ndjekin studimet në UE. Sistemi (EMS) është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Çdo student pajisjet me email-in e tij dhe mund të regjistrohet në llogarinë personale të studentit në EMS.</p> <p>Ndërfaqja e studentëve jep të gjitha detajet në lidhje me ecurinë akademike, aksesimin e materialeve studimore të ngarkuara në sistem nga pedagogu i lëndës. Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik. <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar statutit të UE dhe rregullores së njëjse kryesore, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit.</p> <p>Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë: Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave, Drejtorisë Ekonomike.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi EMS siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik EMS. <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS;</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Konstatohet se sistemi mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve si dhe informimin online. Studentët, pedagogët, por edhe stafi ndihmës akademik mund të identifikohen në EMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive.</p> <p>Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës. Vizita në institucion dhe takimet me stafin akademik dhe studentët e konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të menaxhimit dixhital. <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit EMS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuara sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafi akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. EMS u siguron atyre informacione të përditësuara.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja e internetit të UE paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentë. Departamenti ka dhe faqen e vet, ku jep informacion më të dedikuar për studentët e PS. Gjatë vizitës <i>GVJ konstatoi që departamenti nuk ka një politikë të standartizuar apo manual për publikimin, por kryesisht të gjithë aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit.</i></p> <p><i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB</i>  <a href="https://uniel.ems.al/school/program/5aff45e3-9855-4634-a78d-ade101753ff3.aspx">https://uniel.ems.al/school/program/5aff45e3-9855-4634-a78d-ade101753ff3.aspx</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Aplikimi i sistemit të brendshëm të menaxhimit institucional është një praktikë shumë e mirë mbështetëse e procesit të studimit dhe ka lehtësuar procesin administrativ, informues dhe monitorues të aktiviteteteve akademike e administrative për programin e studimit në punë sociale.</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dokumentacionin e prezantuar nuk gjendet një raport financiar i kostove të programit të studimit. por ka të evidentuar një raportin financiar i cili hartohet nga Drejtoria Ekonomike detajohet dhe paraqitet me zërat e kostove përkatëse për programet e cikleve të studimit (jo në mënyrë specifike për BAPS).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që drejtoria ekonomike ka mundësi të nxjerrë konstat për çdo njësi bazë pasi disponon të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton buxhetin afatmesëm dhe vjetor të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij. Buxheti vjetor përgatitet dhe miratohet sipas udhëzimeve të MFE-së, në zbatim të buxhetit të vitit aktual. Ky buxhet miratohet pasi akordohet Granti për mësimdhënie e transfera tek individët nga ministria e linjës. Planbuxheti vjetor dhe ai afatmesëm i institucionit hartohen nga administratori i UE-së, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UE-së. Planbuxheti vjetor mbështetet në planbuxhetin afatmesëm, në propozimet e njësive kryesore dhe të njësive bazë, pas hartimit të PBA-së, realizimit buxhetor të vitit të mëparshëm, ndryshimeve në strukturë dhe në aktet nënligjore që lidhen me buxhetin.</p> <p>Nuk gjenden të dhëna mbi zërat të cilat financohen nga a-Buxheti i shtetit (Granti për mësimdhënie; Granti konkurues; Granti për kërkimin shkencor); b-Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi. c-Të ardhurat e vetë institucionit (Pagesat e studenteve për arsimim; Të ardhurat për shërbimet e kryera; Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta), të paktën një cikël të plotë studimi</p> <p><i>Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022;</i></p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p><i>Evidenca 4.19 Rregullore ekonomike financiare;</i></p> <p>Në dokumentacionin e përcjellë nuk gjendet plani i dedikuar financimit të programit BAPS, as ai i njësisë bazë por në nivel universiteti ka të dhëna mbi shpenzimet sipas disa zërave. Administrimi bëhet në nivel universiteti dhe alokimi i fondeve për shërbimin e internetit bëhet me anë të një kontrate shërbimi që UE ka; gjithashtu edhe shpenzimet për bibliotekën janë parashikuar; edhe këto në nivel Universiteti duke mos mundësuar saktësimin e fondit për libra dedikuar specifikisht programit të studimit.</p> <p>Në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, viti 2022 gjenden një sër objektsh prokurimesh me vlerat përkatëse, por nuk mund të evidentohen shpenzimet specifike as për njësinë bazë as për programin.</p> <p>Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit “Punonjës Social” do të këshillojm që njësia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</p> <p><i>Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022;</i></p> <p><i>Evidenca 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve 2022;</i></p> <p><i>Evidenca 3.8 Fondi i librit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me planet e miratuara, por në dokumentacionin e shqyrtuar nuk gjenden raporte të përvitshme.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion iu konfirmua se kishte auditime të përvitshme dhe raporte financiare mbi llojin dhe ndarjen e burimeve dhe realizimin e shpenzimeve, por kërkesës që këto raporte periodike auditimi mbi gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të programit të studimit “Punonjës Social” nuk na u vunë në dispozicion.</p> <p>Universiteti i Elbansanit, ashtu si dhe gjithë universitetet publike i janë nënshtruar auditimit “Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë” nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2022, ku analizohet efektiviteti i veprimtarisë së institucionit të Arsimit të Lartë dhe politikave që synojnë mirëmenaxhimin e tyre me synim garantimin e vijimit me cilësi të procesit mesimor, kërkimor</p>





	dhe shkencor në gjëndjen e pandemisë, duke siguruar edhe kushte sigurie shëndetësore për trupën e studentëve, pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë. <i>Evedenca 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022;</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar për UNIEL. <i>Nuk u evidentuan raporte specifike mbi programin e studimit, por në nivel deparamenti.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	UNIEL është një universitet publik dhe si tillë, ashtu si dhe demonstron në planbuxhetin për vitin 2022, Granti publik është dhe zëri më i rëndësishëm (1,241,735,976), pasuar nga të ardhurat e institucionit (545,372,567.06), dhe në fund zëri i projekteve të huaja me një vlerë modeste në total (30.809.982). Këshillohet që njësia të ketë të parashikuar edhe planifikimet për ndërhyrje të posaçme dhe diversifikim të financimit të programit “Punonjës Social” sipas vlerësimit të nevojave për përmirësim të situatës. <i>Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022;</i> <i>Evidenca 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve 2022;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UNIEL është një institucion publik dhe si i tillë financimi dhe mbështetja financiare e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor garantohe në masën më të madhe nga granti publik. Mungojnë informacionet specifike mbi financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programit “Punonjës Social” si dhe evidencat mbi financimin dhe mbështetjen e studentëve të këtij programi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
--	------------------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UNIEL ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së miratiara nga MAS.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UE nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe ngrihet një komision <i>ad hoc</i>, i cili pas shqyrtimit të listës së aplikantëve shpall dhe listën e kandidatëve fitues për programin e studimit “Punonjës Social”.</p> <p>Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në kreun nenin 11 “Pranimet në ciklin e parë të studimeve”; në Kreun IV “Organizmi i studimeve”; Kreun V “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi” të Rregullores së Studimeve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit të UNIEL “Aleksandër Xhuvani” si dhe në nenin 49 të statutit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL;</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL;</i></p> <p><i>5.13 Procesverbal i komisionit të pranimit të maturantëve;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me QSHA-në në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse GVJ</p>



<p>përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>konfirmon që kriteret janë hartuar përpara fillimit të vitit akademik dhe janë publikuar në faqen eeb të UNIEL.</p> <p>Gjithashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës informon mbi kriteret e pranimit dhe fokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në programin BAPS. Senati Akademik çdo vit mirton kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për të gjitha kategoritë, përfshi studentët e huaj dhe ata me nevoja të veçanta.</p> <p><i>Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023;</i></p> <p><i>5.1.1 Vendimi i senatit për kuotat e pranimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe një Vendim senati për kuotat. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Vihet re një numër i lartë i studentëve të çregjistruar në programin BAPS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 9 studentë të çregjistruar në vitin akademik 2019-2020;</li> <li>- 8 studentë në vitin akademik 2020-2021;</li> </ul> <p>Të gjitha informacionet e referuara për pranimin, procedurat dhe dokumentat e regjistrimit, tarifrat, bursat dhe transferimin e studimeve janë të publikuara në faqen e internetit; si dhe gjenden të sanksionuara edhe në Aktet ligjore e nënligjore gjithashtu të publikuara në faqen Web të UNIEL.</p> <p><i>1.11 Analiza Vjetore e FSHE 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimi i ditëve të informimit për maurantët e shkollave të mesme, kryesisht të rajonit dhe konform një plani. Gjithashtu maurantët ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për fakultetin dhe për programe specifike të studimit, edhe për BAPS. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maurantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit të Universitetit.</p>





<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pjesë e vendimit të senatit akademik të UNIEL është dhe vëmendësimi mbi kuotat e veçanta dhe kriteret përkatëse mbi përzgjedhjen e kandidatëve aplikantë të cilët vijnë nga kategori me aftësi të veçanta, pakicat kombëtare apo dhe shteresat e marginalizuara.</p> <p><i>Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>5.1.1 Vendimi i senatit për kuotat e pranimit.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në faqen Web të UNIEL gjenden informacionet mbi vendimet e Senatit Akademik dhe në vendimet e senatit janë të përcaktuara edhe kriteret përzgjedhëse për kandidatët nga shtete të tjera. Aktualisht në këtë program nuk ka studentë të ardhur nga shtete të tjera.</p> <p><i>Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në <i>Evidencën 2,1</i>, gjendet Vendimi Nr.40, datë 02.11.2021, bordi i administrimit evidenton kushtet për procedurën e aplikimit të studentëve në Ciklin e Dytë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë ulje nga tarifa vjetore e shkollimit si student të shkëlqyer, student me rezultate dhe kërkesave me kritere të tjera. Nga vizita në institucion u informuam se studentët të cilët i përkisnin shtresave në nevojë të shoqërisë apo ishin ekselentë përfitonin bursa studimi.</p> <p><i>Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se UNIEL ndjek dhe zbaton politika të qarta e transparente mbi procedurat e pranimit, përzgjedhjes dhe përparimit të studentëve të programit “Punonjës Social”. Gjithashtu edhe transferimi i studimeve, njohja e studimeve në një program tjetër vlerësimi i dijeve dhe diplomimi ishin procedura të njohura dhe transparente për këtë program studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përkrahje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit. Në faqen web dhe në aktet rregullative të universitetit gjendet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. (Neni 17 i Rregullores së programit të studimit BAPS normon se studenti nuk e kalon vitin pasardhës në qoftë se nuk shlyen 50% të krediteve).</p> <p>GVJ konfirmion se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.</p> <p><a href="https://www.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/Fakulteti_i_shkencave_te_edukimit/njoftime/Rregullore%20e%20FSHE.pdf">https://www.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/Fakulteti_i_shkencave_te_edukimit/njoftime/Rregullore%20e%20FSHE.pdf</a></p> <p><i>Evidence 1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kreu VI i Rregullores së FSHE përcakton procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit. Këto procedura mund të aksesohen nga studentët në faqen e institucionit. (<a href="https://www.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/Fakulteti_i_shkencave_te_edukimit/njoftime/Rregullore%20e%20FSHE.pdf">https://www.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/Fakulteti_i_shkencave_te_edukimit/njoftime/Rregullore%20e%20FSHE.pdf</a>)</p> <p>ekuivalentimi bëhet nga Komisioni <i>ad hoc</i> i njohjes dhe ekuivalentimit, përbërja e të cilit propozohet nga njësia bazë përkatëse dhe miratohet nga Dekani; ndërsa transferimi bëhet nga Rektori bazuar në propozimin e Dekanit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf</i></p> <p><i>1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e FSHE, kreu V “Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi”, gjithashtu edhe në Rregulloren e studimeve në UE si dhe në syllabusin e çdo lënde studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë.</p> <p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Ky informim është i vijueshëm edhe gjatë lëndëve të veçanta, gjithashtu ata</p>





	<p>konfirmojnë se edhe procesi i adresimit të shqetësimeve të ndryshme mbi vlerësimin ishte shumë i qartë për ta.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të FSHE-së, konkretisht në Kreu VIII “Diplomimi” si dhe në Rregulloren e Studimeve në UNIEL dhe në Rregulloren e programit të studimit BAPS, në sesionin “Provimi përfundimtar” ku specifikohet edhe struktura e temës dhe vlersimi i diplomës. Për të mbështetur studentët, institucioni ka përgatitur një udhëzues specifik mbi procesin e punimit të diplomës dhe një udhëzues për provimin përfundimtar. Ndërsa manuali i punimit të diplomës i referohet diplomimit Master.</p> <p><i>Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka përgatitur dhe një kalendar të ditëve të hapura në të cilën planifikohen takime vetëm me 23 shkolla në disa ditë të veçanta në ambientet universitetit, takime të cilat i adresohen vetëm 1739 maturantëve. Nuk gjenden udhëzues të posaçëm për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, por nga vizita në institucion konstatoam se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni organizojnë takime me maturanët, vizita të drejtuara në institucion si dhe takime me stafin akademik për informacione edhe më të detajuara. Gjithashtu ata konfirmojnë që organizohen edhe panairët e studimit e të punësimit, kryesisht në qarkun dhe në rrethet pranë Elbasanit, ku dhe shpërndahen fletë informuese dhe materiale promovuese.</p> <p><i>Evidenca 5.2 Kalendar i ditëve të hapura 2022.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se UNIEL ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit punonjës social të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në diplomim.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>





**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve gjenden në faqen web të universitetit sëbashku me rubrikën pyetje të shpeshta (<a href="https://uniel.ems.al/school/program/c85c45a4-3e85-4c62-8dfc-acbf014b17b7.aspx">https://uniel.ems.al/school/program/c85c45a4-3e85-4c62-8dfc-acbf014b17b7.aspx</a>).</p> <p>Studentët që pranojnë në programin e studimit informohen gjatë javës së parë mbi kërkesat dhe kriteret universitare, kohëzgjatjen maksimale të periudhës së studimeve; ndërsa në fillim të çdo viti akademik të tre vitet e studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, regjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe notat përkatëse (<a href="https://uniel.ems.al/home/nees.aspx">https://uniel.ems.al/home/nees.aspx</a>).</p> <p>Në faqen e internetit të UE publikohet orari mësimor dhe i provimeve (timetables), dhe materiale mësimore mbi lëndë të ndryshme (përmes sistemit EMS). Informacioni i detajuar për çdo lëndë ju jepet nga pedagogu i lëndës nëpërmjet komunikimit me e-mail ose dhe formafin hard-copy. GVJ nga konstatimi i sistemit të menaxhimit konfirmoi se informacioni i përcillet studentëve online.</p> <p><a href="https://uniel.ems.al/school/program/c85c45a4-3e85-4c62-8dfc-acbf014b17b7.aspx">https://uniel.ems.al/school/program/c85c45a4-3e85-4c62-8dfc-acbf014b17b7.aspx</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen</p>	<p>Pranë Universitetit funksionin Bordi Këshillimor i Biznesit i cili organizon aktivitete të ndryshme <i>por asnjëra prej tyre nuk i drejtohet specifikisht punësimit të punonjësve social</i>, pasi ka më tepër profil biznesi dhe ekonomik. Edhe nga analiza e të</p>





<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>dhënave mbi punësimin e të diplomuarve për vitin 2020-2021 rezultojnë vetëm 5 punonjës socialë të punësuar, përkatësisht nr.23 e punësuar pranë fondit Besa, nr.124 punësuar në AKU, nr.127 &amp; 128 pranë Bashkisë Belsh, nr.164 punësuar pranë Këshillit të Qarkut. Për vitin 2019-2020, vetëm 3 të punësuar dhe përkatësisht nr. 29, punësuar pranë qarkut Elbasan, nr.35, pranë Bashkisë Belsh, nr.43 punësuar pranë Bashkisë Pogradec. Për vitin akademik 2018- 2019, rezultojnë 6 të unësuar, nr. 3&amp; 5 pranë Postës Elbansan, nr.19 pranë Spitalit psikiatrik, nr.37&amp;40 pranë Keshillit të Qarkut, nr.61 Bashkia Rrogozhinë, Nga takimi që GVJ pati me studentët ata nuk kishin informacione mbi studimet e tregut të punës, si dhe nuk ishin orientuar drejt mundësive të punësimit dhe tregut të punës. Kjo mund të jetë edhe për shkakun se pritet që ata të përfundojnë ciklin e dytë të studimeve para se t'i drejtohen tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor afishohet në faqen e internetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Gjatë takimeve dhe seancave orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. Gjatë takimeve në institucion GVJ konfirmon se informacioni që ju vihej në dispozicion ishte i plotë e shterues.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Çdo pedagog ofron komunikimin nëpërmjet sistemit EMS dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. Studentët mund të futem me email-in e tyre në sistem nëpërmjet portalit të studentëve, ku gjejnë të gjithë informacionin. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit nëpërmjet kodit të përdoruesit dhe fjalëkalimit duke pasur kështu një llogari të personalizuar për ndërveprimin institucional. Sistemi menaxhon dhe arkivon të dhënat.</p> <p>GVJ gjatë takimit me studentët konstaton se ata kishin dhe kopje fizike të syllabusve për cdo lëndë, të cilat ju viheshin në</p>





	dispozicion nga pedagogët e lëndëve në javën e parë të mësimit.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat objektivat formues të secilës lëndë; kishin informacion të plotë e të hollësishëm për, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, por nuk kishin informacione përsa i përket studimeve mbi tregun dhe mundësitë e punësimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4


**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjishme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. Ndërkohë mesatarja në hyrje ka qënë mbi 8.6 në të tre vitet e fundit akademike. Gjatë vizitës në institucion u vërejtën se sekretaria mësimore administronte, rregjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe vërejtji disa rubrika të paplotësuara. <i>(RVBP_BA_BUS_Tabelat_permbledhese_shqip.pdf, tabela nr.21)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	Institucioni disponon statistika për numrin e të rregjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në PS për 3 vitet e fundit akademike është 144 nga të cilët vetëm 14 janë studentë të transferuar. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale. Një pjesë e të dhënave janë pjesë edhe e analizës së universitetit dhe nuk ka të dhëna për publikim të raportit vjetor.





<p>sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për katër vitet e fundit akademike ishte:</p> <p>Viti 2018-2019 63 studentë, (Nota mesatare H 6.78 dhe D 6.56);</p> <p>Viti 2019-2010 45 studentë, (Nota mesatare H 7.21 dhe D 6.76);</p> <p>Viti 2020-2021 34 studentë, (Nota mesatare H 7.13);</p> <p>Viti 2021-2022 44 studentë;</p> <p>Viti 2022-2023 17 studentë;</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga raporti vjetor i veprimtarisë në Universitetin e Elbasanit për vitin 2020-2021, rezulton se kalueshmëria e studentëve të vitit të parë është 84,62%, për vitin e dytë 64.44% dhe viti i tretë 83.33% (fq.71).</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printojë listën e notave për studentët e vet. Sekretaria lehtësisht mund të llogaritë mesataren për çdo semestër dhe mesataren e përgjithsme e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njëjësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve.</p> <p>GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p>





veprimtarinë e tyre përkatëse.									
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë duhet të bëjë një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje gjë e cila nuk na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion, por të dhënat statistikore mbi mesataren janë lehtësisht të aksesueshme nga sistemi i menaxhimit. Në këtë raport analitik duhet të reflektohen edhe masat e marra për përmirësimin e treguesve kryesisht ato të cilat lidhen me cilësinë e punësimit të studentëve.  <i>GVJ nuk aksesoi asnjë analizë vjetore mbi profilin punonjës social.</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave dhe sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit "Punonjës Sociale". të dhënat ruhen edhe në rregjistra të posaçëm nga pranimi dhe rregjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, por nuk ka të dhëna të punësimit të tyre.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i UE si dhe Rregulloret e Universitetit, dhe në atë të Fakultetit <i>neni 67</i> , kanë të sanksionuara përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".  Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët pjesëmarrës në takimi nuk kishin informacione mbi



	<p>përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik apo edhe në Këshillin Studentor (<i>sipas Statuti neni 68</i>).</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ konfirmoi se përfshirja e studentëve mundësohej nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur nga secili pedagog në fund të semestrit; por nuk kishte evidenca mbi përfshirjen e studentëve në vendim marrje apo konkretisht mbi procesin akademik, ndaj këshillohet krijimi i praktikave sa më përfshirëse të studentëve në të gjithë proceset akademike e mësimdhënëse dhe përfshirja e tyre në sa më shumë grupe pune ku ata mund të prezantojnë qëndrimet e tyre; si dhe të ndërgjegjsohen mbi efektin në vendimmarrje.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi. Statuti (<i>neni 58</i>) dhe rregullorja e Fakultetit të FSHE (<i>Kreu VI</i>) parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, mobilitetet e studentëve dhe ripranimin në programin e studimit. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.</i> Nga takimi me studentët ata nuk ishin në dijeni as të funksionimit dhe të aktiviteteve të këshillit studentor. Mund të këshillohet përfshirja e studentëve në mbledhje të përbashkëta në departament duke garantuar kështu edhe kointributin e tyre në të gjithë proceset akademike e mësimdhënëse si dhe duke ofruar një model që reflekton</p>






	sugjerimet e kontributin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre.			
	<i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i>			
	<i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf</i>			
	<i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast.  GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë.  <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL.pdf</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se institucioni kishte ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, por nga kontakti dhe takimi me studentët nuk u evidentuan raste kur ata të ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit "Punonjës Social".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
		X		

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore	UNIEL ka krijuar strukturën e vet, e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, vën në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me





dhe aktet rregullatore të institucionit.	informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.  <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi (EMS) i cili është në dispozicion të çdo studenti. Në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit.  Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi asistimin e tyre përgjatë procesit mësimor me të gjithë çështjet që lidhen me programin e studimit në “Punonjës Social”, por nuk na u vunë në dispozicion evidenca të cilat të dëshmojnë egzistencën e një sistemi të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e tyre. Kështu që këshillohet ndërtimi i një sistemi të posaçëm për studentët e këtij programi me qëllim asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.  <i>Takimi gjatë vizitës në institucion</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ u informua që zyra ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen.  Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve dhe organizatave të ndryshme.  Mungojnë evidencat specifike për studentët e programit punonjës social mbi orientimin për praktikën profesionale dhe orientimin në tregun e punës.  <i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e	Sektorit i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka si detyrë gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo disponon një bazë të dhënash mbi studentët e diplomuar në këtë institucion, e cila përfshihet edhe në Analizën vjetore të institucionit.





<p>punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet e UNIEL.</p> <p>Mungojnë evidencat specifike nga Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit për studentët e programit punonjës social të cilët nuk janë monitoruar dhe për të cilët nuk ka të dhëna të vijueshme mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre, ndaj këshillohet ndërtimi i një mekanizmi i cili mban dhe ua vë në dispozicion të dhënat studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf</i> <i>Shënime gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se procedurat për asistimin e studentëve janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, është duke vijuar punën, për orientimin dhe këshillimin e studentëve, dhe në disa raste dhe në menaxhimin e ankimimeve e problematikave, por jo specifikisht për studentët e programit "Punonjës Social", për të cilët nuk rezultojnë të dhëna dhe nuk ka mekanizma të disponueshme.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

#### IV. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin</p>	<p>UNIEL ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit. Statuti parashikon ngritjen e komisioneve të përhershme siç është Komisioni për</p>





<p>e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit; Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës apo dhe Komisioni për mbrojtjen e studentëve, cili funksionon në nivel njësie kryesore (<i>Neni 24 Komisionet e përhershme</i>). Në nenin 71 të Statusit sanksionohen detyrat dhe kompetencat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, IAL ka ngritur edhe ka në funksionim Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili konform ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon dhe pyetësorët për matjen e performancës.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UNIEL ka ngritur struktura dhe miratuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë në RSH" dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në bazë të statutit, institucioni e ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili monitorohet nëpërmjet Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor." dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje (Neni 24, Statuti UNIEL).</p> <p>GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe është duke funksionuar, <i>por nuk ka mjaftueshëm staf për të përmbushur të gjithë detyrimet.</i></p> <p><i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët janë pjesë e komisioneve të përhershme institucionale, por edhe të fakultetit, ata përfaqësohen me 1 anëtar në të dy këto komisione. GVJ kontaktoi me Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultet dhe me studenten pjesë e tij. Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të performancës garantohen nëpërmjet pyetësorit të studentëve për matjen e performancës. Nga takimi që realizoi GVJ me studentët konfirmoi se vlerësimi i dijeve dhe ankimimi mbi të realizohej sipas përcaktimeve të rregullores së fakultetit, por</p>



	<p>ata që morën pjesë në takim nuk i kishin përdorur të gjithë instrumentët, vetëm konsultimin me pedagogun.</p> <p><i>Evidenca 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC referuar metodologjisë së vlerësimit, instrumenteve matëse dhe instrumenteve të vlerësimit, monitoron progresin dhe suksesin e cilësisë së mësimdhënies. Të dhënat grumbullohen, përpunohen nga NJSBC dhe bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit. IAL i është nënshtruar vlerësimit institucional dy herë dhe ka marr vlerësim pozitiv, vlerësimi i fundit i ka dhënë institucionit akreditim maksimal me 6 vite.</p> <p>Të dhënat e pyetësorit për performancën publikohen me qëllim arritjen e një audience më të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Gjithashtu hartohet edhe një raport vjetor i cili dërgohet edhe në MAS, i cili përmban informacione mbi treguesit kryesor të performancës së programeve të studimit, rezultatet e të nxënësve, kalueshmëria apo dhe niveli i diplomimit.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Shtojca nr. 3. FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT</i></p> <p><i>Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve UNIEL vlerëson edhe performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marr në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentën dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënësve. GVJ nga takimi që realizoi me Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u informua se për programin “Punonjës Social” nuk ka një vlerësim performancë dhe se sektori e ka të pamundur të realizoj një vlerësim të tillë për të gjithë programet e UNIEL. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë, por duhet të angazhohet edhe më tepër për të bërë procesin transparent me anë të publikimit të të dhënave të siguruar nga vlerësimet e ndryshme, veçanësisht të atyre të studentëve.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UNILE ka të përcaltuar qartë politikë në nivel institucional dhe në nivel të fakulteteve për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe është në fazën e përmbylljes së udhëzuesve të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe</i></p>



	<i>monitorimit, në mënyrë që dhe komisionet në nivel fakulteti të nisin procesin.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>UNIEL në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka organizuar dhe ka miratuar mënyrën e funksionimit të Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilesise, i cili ndër përgjegjësitë e tjera ka dhe menaxhimin e procesit të matjes së performancës, nëmërmjet zhvillimit të pyetësorëve institucionalë. Gjithashtu parashikimet ligjore mandatojnë Departamentin si njësi përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse, por GVJ nuk ka evidentuar raporte të cilësisë së programit BA në “Punonjës Social”.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Departamenti DSHSEQ, si njësi bazë e menaxhimit të programit të studimit propozon ndryshimet në kurrikulën e programit. Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë së rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % të programit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë.	<p>Nga vizita në institucion, kërkesës së GVJ për evidentimin e instrumenteve që IAL përdor për të matur ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve ishte vetëm pyetësori i studentëve për vlerësimin e lëndës. Pyetësori i Studentëve.pdf ,nga</p>



<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>verifikimi i të cilit rezulton se nuk është një pyetësor për studentët por për të nxënë të gjetë gjithë jetës.</p> <p><i>Pyetësor ALUMNI.pdf</i></p>
---	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Raportet e deritanishme nuk janë të fokusuara në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik BAPS. Nga analiza e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional evidentohet se rezultatet e pyetësorëve me studentët janë një instrument që përdoren në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe iu paraqiten të gjithë strukturave përkatëse duke nisur nga departamentet deri në Senatin Akademik.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.pdf</i></p>
---	---

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti i Elbasanit ka hartuar dhe ka zbatuar politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë, por këto politika nuk janë zbatuar ende deri në nivelin e programit të studimit bachelor në "Punonjës Social". <u>GVJ sugjeron krijimin e praktikave efçente të garantimit të cilësisë së programit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</u></i></p>
---------------------------	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>






<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë (Neni 25 Departamenti) Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucion. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare. GVJ konstatoi që DSHSEQ ka kryer një analizë për vitin 2020-2021, dhe nuk ka informacione mbi mënyrën se si bashkëpunojnë Komisionet me Departamentin dhe Dekanatin për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> <p>Gjatë takimit në institucion nuk u njohëm me ndonjë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, apo rishikimin e programeve të studimit të programit BAPS.</p> <p><i>Evidenca 1.14 Analiza e Departamentit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit IAL përdor vetëm një instrument (për vlerësimin e mësimdhënies), vlerësimi i publikimeve dhe aktivitetit akademik.</p> <p>GVJ konstaton se pyetësori pjesë e shtojcës 2.8 i referohen vlerësimit të nevojës për trajnime për të nxënësit gjatë gjithë jetës për mësuesit, drejtuesit e shkollave, shoqatat e mësuesve si dhe për stafin e universitetit, pjesë e projektit TEAVET</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumenti i përdorur është i pamjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundsohet përdorimi periodikisht i tyre.</p> <p><i>Evidenca 2.8.1 Pyetësori i Studentëve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të</p>	<p>Për të realizuar vlerësimin e programit “Punonjës Social” përdoren disa metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve.</p>





<p>drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi që IAL përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korigjimit të provime, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. IAL gjithashtu përdor disa instrumenta të drejtpërdrejtë për të vlerësuar cilësinë e programit dhe konkretisht pyetësorin për vlerësimin e lëndës dhe pyetësorin me studentët alumni. Kështu vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri. Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit.</p> <p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që departamenti nuk përdor asnjë instrument të tërthortë vlerësimi, duke mos mundësuar kështu një vlerësim të plotë të realizimit të objektivave të programit BAPS dhe duke mos mundësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Spektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës, drejtuar studentëve në fund të çdo semestri; edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, mbledh dhe përpunon periodikisht të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve. Në fakt këto janë metoda të drejtpërdrejta të mbarëvajtjes së cilësisë së programit. Sondazhet me studentët të cilët vijonë studimet në Institucione të tjera të Arsimit të Lartë, mundësisht jashtë vendi apo dhe intervistat me ata ish-studentë të cilët ushtrojnë profesionin apo dhe janë të punësuar në fushën e shërbimeve dhe politikave sociale në vende ku shkencat sociale janë më të zhvilluara, do të ishin mjete shumë të vlefshme për sigurimin e të dhënave mbi përgatitjen e tyre dhe aftësimin për tregjet akademike apo profesionale ndërkombëtare.</p> <p><i>GVJ sygjeron që e njëjta procedurë (intervista gjysëm të strukturuar, fokus grupe apo dhe sonadaxhe), periodike dhe e strukturuar të ndiqet në vijueshmëri nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo dhe punëdhënës aktual apo potencial të studentëve të këtij programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi, por dhe vlerësimit të aftësive dhe kompetencave që ky program garanton dhe përputhshmërisë së tyre me treguesit real të avancimit akademik apo karrierës profesionale.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë ka organizuar njësitë dhe ka sanksionuar monitorimin dhe vlerësimin përmes njësitë të</i></p>





	<i>posaçme, por ende nuk kemi raportin e parë për këtë program studimi, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ nxit strukturat e ngritura në nivel fakulteti dhe departamentin të vlerësojë programin në mënyrë holistike duke integruar të dhënat nga burimet e drejtpërdrejta dhe ato sekondare për të vlerësuar dijet akademike dhe kompetencat e fituara nga ky program, si një mundësi shumë e mirë e garantimit të cilësisë së tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### **Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në UNIEL është ngritur dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligiit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, mbledh dhe përpunon periodikisht të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve. Në statusin e universitetit janë parashikuar komisione të përhershme në nivel institucional si:</p> <p>Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE- dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve;</p> <p>Komisioni për mardhëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studenteve;</p> <p>Statusi parashikon dhe Komisione të përhershme në nivel njësie kryesore:</p> <p>Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë së njësisë</p>




	<p>kryesore dhe programeve të studimit, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, 4 (katër) nga personeli akademik i njësisë kryesore dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve;</p> <p>Komisioni për mbrojtjen e studentevë, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore, dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve;</p> <p><i>Statuti UE, Neni 24 Komisionet e përhershme.</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Kështu me Vendimin nr. 01, datë 28.01.2020 Senati Akademik ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Gjithashtu me Vendimin nr. 02, datë 28.01.2020 Senati Akademik ka miratuar rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm në nivel institucioni për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. Gjithashtu ka rregullore për një sër funksionesh siç është Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për këshillin studentor të UE. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><a href="https://www.uniel.edu.al/images/universiteti/legjislacion/Rregullore_pr_Organizimin_dhe_Funksionimin_e_Komisionit_t_Prhershme_nivel_institucioni_pr_marrdhniet_me_stude.pdf">https://www.uniel.edu.al/images/universiteti/legjislacion/Rregullore_pr_Organizimin_dhe_Funksionimin_e_Komisionit_t_Prhershme_nivel_institucioni_pr_marrdhniet_me_stude.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ konfirmoi se nuk ka një procedurë vlerësimi dhe siguri cilësie për programin e studimit BA në “Punonjës Social”, edhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar detyrimet e Departamentit për ndërtimin e sistemit të sigurimit të cilësisë (<i>nenet 20-25</i>). Komisioni i përhershëm në nivel fakulteti kishte vetëm pak muaj që ishte ngritur dhe ende nuk kishte realizuar vlerësime.</p>





administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<p>Nga takimi me stafin akademik ata konfirmojne se vetë realizojnë pyetësor dhe takime me studentët, ndërkohë që vlerësim të sturukturuar ende nuk kishin realizuar.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>GVJ konstatoi se edhe pse referuar <i>Nenit 20</i> të Rregullores së programit të studimit- Departamenti ngre njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme me veprim të përhershëm me tre deri në pesë anetarë, kjo njësi ende nuk është ngritur, por funksionon vetëm komisioni në nivel Fakulteti ku ka përfaqësues nga një anëtar nga secili department.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BAPS.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Duke ju referuar dokumentacionit, dhe shënimeve të mbajtura nga GVJ gjatë vizitës në institucion konstatohet se, UE nuk ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në KPSC dhe zbatimit të instrumentave të ndryshme të vlerësimit.</p> <p>Pyetjes së GVJ mbi angazhimin e ekspertëve apo bashkëpunëtorëve të jashtëm për dhënien e mendimeve mbi cilësinë e programit dhe përmirësimin e cilësisë së tij, stafi akademik efektiv dhe me kontratë iu përgjigj se nuk e shihnin të arsyeshme përfshirjen e tyre.</p> <p><i>Takime gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Ende nuk është realizuar një vlerësim nga komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti edhe pse kuadri rregullator egziston. GVJ rekomandon që ky vlerësim për këtë program studimi të jetë sa më i plotë dhe me përfshirjen e të gjithë palëve të procesit, përfshi edhe ekspertë të jashtëm, për të garantuar kështu cilësinë e programit dhe për të kontribuar një përmirësimin e plotë të tij.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	


**Standardi VI.5**





**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqen e internetit të institucionit (<a href="https://www.uniel.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ue">https://www.uniel.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ue</a>) gjenden të publikuara informacione të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e NJSBC si dhe një fletëpalosje informuese (<a href="https://www.uniel.edu.al/images/NJSBC/Fletepalosje_NJSB_C.pdf">https://www.uniel.edu.al/images/NJSBC/Fletepalosje_NJSB_C.pdf</a>) por nuk u mundësua gjetja e dokumenteve publike mbi politikën e cilësisë dhe ajo që është më e rëndësishmja mbi raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm (institucional dhe për çdo program studimi), dhe raportet vjetore të IAL. E njëjta situatë edhe në faqen e internetit të departamentit ku nuk u mundësua gjetja e dokumenteve të publikuara të raporteve vjetore të departamentit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL të mundësojë transparencë maksimale për të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Programi në fjalë është në procesin e akreditimit për herë të parë. Nga verifikimet e kryera nuk rezulton të jenë bërë publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësorëve, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Aktorët e interesuar nuk kanë mundësi të njihen me këto raporte.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti nuk ka një plan masash për të adresuar rekomandimet e Bordit të Akreditimit në kuadër të vlerësimit të jashtëm. Plani i veprimit është miratuar nga Senati Akademik. Rekomandimet dhe statusi i plotësimit të tyre janë të publikura në faqen e internetit të IAL/NJSBC. Njësitë administrative dhe ato akademike përgatisin gjithashtu plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të auditit të brendshëm të Universitetit. Gjatë vizitës në institucion nuk na u mundësua një plan masash për adresimin e pikave të dobta të vlerësimeve të programit Bachelor të studimit “Punonjës Social”</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë</p>





e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre.

*GVJ rekomandon që krahas këtyre raporteve NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar.*

**Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë.

Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:

- Informimi i stafit për proceset e vlerësimit;
- Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit;
- Përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës;

**Konkluzione**

*GVJ këshillon që veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të bëhen sa më parë praktikë e punës për Departamentin dhe të jenë publike, transparente, lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë grupet e interesit si dhe të jenë efektive e të synojnë krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë, e cila ende nuk është krijuar.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë

### Bachelor në “Punonjës Social”

#### **a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik;
2. Staf i kualifikuar dhe i trajnuar si pjesë e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare -T@sk;
3. Mundësi punësimi në sektorë të ndryshëm;
4. Sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional është një praktikë shumë e mirë mbështetëse e procesit të studimit dhe lehtëson procesin administrativ, informues dhe monitorues të aktiviteteve akademike e administrative për programin e studimit punonjës social;
5. Mundësia që u jepet studentëve për kryerjen e praktikave aktive në institucione dhe organizata të ndryshme në mënyrë preferenciale;
6. Përdorimi i teknikave dhe metodave bashkëkohore në mësimdhënie me në qendër studentin;
7. Kërkesë e lartë për studime në këtë fushë;
8. Organizimi i konferencave shkencore dhe workshopeve me partnerë ndërkombëtarë;
9. Rritja e cilësisë së mësimdhënies nga mobiliteti i stafit akademik me universitete partnere ndërkombëtare;
10. Vënia në dispozicion e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në diplomim;
11. Pasja e një sistemi për menaxhimin e të dhënave ku sekretaria mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit “Punonjës Sociale”;

#### **b. Pika të dobta:**

1. Mungesë e hapësirës së posaçme juridike në rregulloren e departamentit për rolin dhe funksionin e koordinatorit të programit të studimit; (**Standardi I.2, kriteri 1**)
2. Mangësi e lehtë në kreditet e lëndëve të kategorisë B (50% - 55% ) sipas përcaktimeve të VKM nr.41/2018 për të respektuar përcaktimin për përqindjen totale të lëndëve të kategorive A dhe B (70%); (**Standardi II.4 kriteri 1**)



3. Mungesë e personelit akademik punonjës social (të zotëroj njohuritë akademike mundësisht në të tre nivelet e formimit), me kualifikimet përkatëse në përputhje me veçorinë e moduleve, në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit për fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike;  
*(Standardi IV.1, kriteri 1)*
4. Mungesë e numrit të titujve në fushën e punës sociale në bibliotekën e Fakultetit dhe atë të UE;  
*(Standardi IV.2, kriteri 1)*

#### **Rekomandime:**

1. Krijimi i hapësirës së posaçme juridike në rregulloren e departamentit për rolin dhe funksionin e koordinatorit të programit të studimit;
2. Rritja e numrit të krediteve të lëndëve të kategorisë B në intervalin 50% - 55% kreditë;
3. Rishikimi i ndarjes së lëndëve mësimore dhe moduleve, në referencë të kualifikimeve dhe ekspertizës së pedagogëve përputhje me fushën kërkimore dhe eksperiencën praktike në punë sociale, duke mundësuar që të paktën lëndët karakterizuese të programit të lëtohen nga personel akademik tërësisht i kualifikuar në punë sociale;
4. Rishpërndaja e ngarkesës me orë mësimore në auditor sipas Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018;
5. Shtimi fondeve të librave në punë sociale dhe përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit;

#### **Conclusions of the evaluation of the first program Bachelor in “Social Worker”**

##### **a. Strengths and Affirmations:**

1. Learning environments and infrastructure made available by HEIs are suitable, fulfil and guarantee the realization of the teaching process and theoretical and practical training;
2. Qualified and trained staff as part of participation in international projects -T@sk;
3. Employment opportunities in different sectors;
4. Internal institutional management system as a very good supporting practice for study process which also enable facilitation of administrative, information and monitoring process of academic and administrative activities for the social worker study program;
5. The opportunity given to students to perform active internships in various institutions and organizations on a preferential basis;
6. Use of contemporary techniques and methods in student-centered teaching environment;
7. High demand for studies in this field;
8. Organization of scientific conferences and workshops with international partners;



9. Increasing the quality of teaching through the mobility of academic staff with international partner universities;
10. Making available all necessary information on admission, program, assessments and criteria for passing to graduation;
11. Having a data management system where the secretariat collects, administers, updates and stores detailed data about students, evaluations and the profile of students following the "Social Work" study program;

**b. Weak points:**

1. Lack of special legal space in the department's regulation for the role and function of the coordinator of the study program; *(Standard I.2, criterion 1)*
2. Slight deficiency in the credits of category B subjects (50% - 55%) according to the provisions of VKM no. 41/2018 to respect the definition for the total percentage of subjects of categories A and B (70%); *(Standard II.4 criterion 1)*
3. Lack of academic social worker personnel (social work academic knowledge, preferably at all three levels education in SW), with the relevant qualifications in accordance with the features of the modules, covering the subjects/modules of the program for the research field and practical experience; *(Standard IV.1, criterion 1)*
4. Lack of the up-to-date literature and book titles number especially for core subjects in the field of social work in the Faculty and UE library, *(Standard IV.2, criterion 1)*

**Recommendations:**

1. Creation of a special legal space in the department regulation for the role and function of the study program coordinator;
2. Increase the number of credits for B category courses in the range of 50% - 55% credits;
3. Revision of the division of teaching subjects and modules, in reference to the qualifications and expertise of lecturers in accordance with the research field and practical experience in social work, enabling at least the characteristic subjects of the program to be taught by academic staff fully qualified in social work;
4. Redistribution of the workload with teaching hours in the auditorium according to Instruction No. 29, dated 10.09.2018;
5. Increasing funds of books in social work and updates literature with publications of recent years;





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

